

Proces - Verbal

Per:

1967

20.08.2025

"Konsultimin Publik për miratimin e Planit Vendor i
Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve"

Bashkia Selenice



Ju baktur sot me 20.08.2025, ora 10:00 pran
ambienteve të Bashkisë Selenice për konsultimin publik
për miratimin e planit Vendor të menaxhimit të integruar të
mbetjeve sipas njoftimit të Bashkisë Selenice:

Të kimsi filloje me prezantimin e planit në disa pika
përmbledhëse ku ky plan është një dokument i cili
mundëson zbatimin e politikave të mbetjeve në nive
lokal si një dokument udhëzues për menaxhimin e mbetje
në Bashkinë Selenice.

Të pranishmit diskutuan në lidhje me çështjen

Kryetari: Nertil Bellaj

N. Kryetar: silvana Islamay

Ayfetor



- 1 - Shtimi i koshave për bizneset dhe për familjar
- => Welerja e mbetjeve plastike dhe letra në kosha të ndryshëm
- => Pastrimi i territorit dhe përmirësimi i infrastrukturës
- => Pastrimi i fushës së sportit në fshatin kote nga gjëra dhe mbeturinat dhe rregullimi i koshave.
- => Kryetari
- => Kërkimi i planeve në s-vjeçarin e ardhshëm shtrirjen e pastrimit në gjithë territorin e bashkisë.
- => Mbrojtja e vlerave mjedisore dhe turistike
- => Reduktimi i ndotjes në zonat urbane dhe rurale
- => Depozitimi i mbetjeve në landfillin e Sherrskites dhe mbyllja e dy venddepozitimeve në territorin e Bashkisë Selenice.

27

Koordinatori për konsultimin Publik

Enida Kola.

Administratore e Njesive

Florian Mervaj

N. Ad. Kate. 

Klevis Ballaj

N. Ad. Brataj 

Bujar Porshaj

N. Ad. Sevaster

Erjon Petraj

N. Ad. Armer 

DORAC COTAJ

DR. KASIMATI

Ermal Fikaj

D. Tahiri / taksat.

Enolri Jahaj 



Dylhetan


Herva Rrapaj



Anetore keshilli
GENTJANA ARSHI


Mene Armeraj



Gjegji Myrtaj 

ARTUR JAU PAJ

ARBER ÇECLAJ



Sporistak Domokso



Tamir Mur 

Kordinatonga por konsultimin publike Enidla Kola




BASHKIA SELENICE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË
DREJTORIA E SHERBIMEVE ADMINISTRATIVE , PASTRIM DHE GJELBERIMIT**

Nr 1983 prot

Selenicë, më 21.08.2025

PROJEKT-VENDIM

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TE INTEGRUAR TE MBETJEVE
I BASHKISE SELENICE 2025-2030**


Mbeshtetur ne ligjin Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 10463, datë 22/09/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 12 dhe neni 13(i ndryshuar) Ligjit Nr.10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”(I ndryshuar), Ligjit Nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjit nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", VKM Nr. 418/2020, “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, VKM Nr. 671/2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe me urdhrin e kryetarit nr.1908 date 07.08.2025

PROPOZOJME

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Selenice 2025-2028


2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e shërbimeve Administrative, pastrim Gjelberimit dhe Drejtoria e Shërbimit Financiar-arkiv protokollit
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

Kryetar
Nertil Bellaj



Drejtori I Shërbimeve Administrative , pastrim dhe gjelberimit

Endri Jahaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SELENICË

DREJTORIA E SHERBIMEVE ADMINISTRATIVE , PASTRIM DHE GJELBERIMIT

Nr 1983 / prot

Selenicë, më 21/08.2025

RELACION

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TE MENAXHIMIT TE MBETJEVE TË BASHKISË SELENICË 2025-2030”

Te nderuar Keshiltare,

Në zbatim të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkia Selenicë ka hartuar Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) për periudhën 2025–2030.

Deri me sot Bashkia Selenice nuk ka patur nje plan te miratuar per menaxhimin e mbetjeve .Si nje detyrim ligjor , lindi nevoja per hartimin e tij ku me urdher te mbrendshem u ngrit grupi I punes

Ky dokument është një planifikim strategjik dhe praktik i cili percakton menaxhimin e mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë Selenice per nje afat 5 vjecar , duke përfshirë njësitë administrative: Selenicë, Armen, Kotë, Vllahinë, Brataj dhe Sevaster. Hartimi i tij është bërë nga administrata e Bashkise Selenice me asistencën e programit të financuar nga Qeveria Gjermane përmes KfW dhe konsulencës se eksperteve te projektit Bashki te Forta .

Plani ka kete perberje :

1-Gjendja aktuale e menaxhimit të mbetjeve:

- Popullsia e bashkisë llogaritet rreth 16,837 banorë me një gjenerim vjetor prej 3,206 ton mbetjesh.
- Shërbimi i mbledhjes së mbetjeve mbulon rreth 65% të popullsisë, kryesisht në zonat urbane dhe qendrat e njësive administrative.

- Niveli i arkëtimeve nga tarifat është mesatarisht vetëm 31–35%, duke vështirësuar qëndrueshmërinë financiare të shërbimit.
- Infrastruktura ekzistuese përbëhet nga 220 kontenierë, 50 kosha, 3 kamionë teknologjikë dhe mjete të tjera ndihmëse, për mbulimin e gjithë territorit.
- Mbetjet depozitohen në 2 venddepozitimet Ne Bashkinë Selenice të cilat me funksionimin e landfillit të shërbimit do të mbyllen
- Aktualisht kostot e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve shkojnë 14,577,967 leke në vit dhe pritet që me funksionimin e Landfillit kjo kosto të rritet me 10.000.000 leke
- Llogaritja e shkallës së gjenerimit të mbetjeve, duke përdorur koeficientin e parashikuar në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta varion midis 0.6 kg/banor/ditë (fshatra) dhe 0.8kg/banor/ditë (Qyteti Selenicë) me një total vjetor të gjenerimit të mbetjeve prej 3206,7ton/vit.

2-Objektivat strategjikë të PVMIM 2025–2030:

1. Vendosija e një sistemi të integruar e gjithëpërfshirës për menaxhimin e mbetjeve
2. Reduktimi i mbetjeve organike përmes kompostimit në familje dhe njësitë administrative rurale.
3. Zgjerimi i shërbimit të mbetjeve nga 65% mbulim sot, në 82% deri në vitin 2030.
- 4- Depozitimi në landfillin e Shërbimit
4. Përmirësimi i financimit dhe rritja e arkëtimeve
5. Ndërgjegjësimi dhe përfshirja e qytetarëve e bizneseve, nëpërmjet fushatave informuese dhe edukimit të brezit të ri.

3-Masat kryesore që parashikon Plani:

- Vendosija e koshave dhe kontenierëve të rinj për rritjen e mbulimit.
- Organizimi i mbledhjes së diferencuar të plastikës, letrës/kartonit dhe qelqit.
- Nxitja e kompostimit të mbetjeve organike në zona rurale.
- Zbatimi i tarifave të pastrimit të bazuara në kostot reale dhe lehtësimi i arkëtimeve.
- Fushata ndërgjegjësimi për riciklimin dhe edukimin mjedisor.
- Përfshirja e shkollave, bizneseve dhe komunitetit në skema bashkëpunimi.

4-Arsyet për miratimin e planit:

- Situata aktuale nuk siguron shërbim të plotë dhe të qëndrueshëm.
- Shërbimi është i fragmentuar dhe ka nevojë për përmirësim të infrastrukturës.
- Arkëtimi i ulët i tarifave rrezikon vetë funksionimin e shërbimit.
- Rritja e fluksit turistik dhe ekonomik po gjeneron më shumë mbetje se kapacitetet ekzistuese.

Përfundim:

Miratimi i këtij Plani është kusht i domosdoshëm për:

- Mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit;
- Përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve;
- Ndërtimin e një sistemi modern dhe të qëndrueshëm menaxhimi;
- Përshtatjen me standardet e BE-së.

Për këto arsye, i propozohet Këshillit Bashkiak të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025–2030 të Bashkisë Selenicë.

Ky relacion është përgatitur mbi bazën e dokumentacionit të planit 2025–2030 të Bashkisë Selenicë.

**KRYETAR
NERTIL BELLAJ**

Konc: E. Jahaj



Nr 1983/prot
12Date 21.08. 2025

Plani Vendor

i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë 2025–2030

KRYETARI

NERTIL BELLAJ

Hartoi grupi punes :

S.Islamaj

E.Jahaj


S.demaj

E.Fikaj

K.Sinanaj

J.Ngucaj

K.Bedinaj



PASQYRA

0	Parathënie	9
1	Konteksti kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve (MIM)	10
1.1	Vëzhgim i përgjithshëm mbi menaxhimin e mbetjeve dhe vlerësimi i BE për progresin.....	10
1.1.1	Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit	10
1.1.2	Legjislacioni kombëtar për mbetjet	13
1.2	Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor.....	14
1.2.1	Niveli kombëtar.....	14
1.2.2	Niveli rajonal	15
1.2.3	Niveli vendor	15
2	Konteksti vendor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta	16
2.1	Profili i Bashkisë	16
2.2	Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki	19
2.3	Sasia e mbetjeve, burimet dhe karakteristikat	25
2.4	Shërbimet dhe praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve	26
2.4.1	Fshirja e rrugëve	28
2.4.2	Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve	28
2.4.3	Tarifat e pastrimit dhe ekonomia.....	30
2.4.4	Plani dhe realizimi i të ardhurave.....	34
3	Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve	37
3.1	Fushëveprimi i Planit Vendor.....	37
3.2	Kuadri strategjik	38
4	Planifikimi i shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve	39
4.1	Ofrimi i shërbimit MIM në territorin e bashkisë Selenicë	39
4.1.1	Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve	40
4.1.2	Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve	41

4.1.3	Fshirja e rrugëve	43
4.2	Sistemi rajonal i menaxhimit të mbetjeve bashkiake.....	43
4.2.1	Trajtimi i mbetjeve.....	44
4.2.2	Rikuperimi i mbetjeve	45
4.2.3	Mbetjet inerte, mbetje nga ndërtimet dhe prishja e objekteve	48
4.3	Përmirësimi i mjedisit dhe peizazhit	49
5	Çështje organizative dhe institucionale	51
5.1	Struktura institucionale për shërbimet e MMN	51
5.2	Kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve	52
5.3	Dokumentimi dhe raportimi.....	53
6	Kostoja dhe financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen	54
7	Informimi publik, pjesëmarrja dhe ndërgjegjësimi	56
7.1	Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje.....	57
7.2	Shmangia, reduktimi dhe ndarja e mbetjeve për një mjedis më të pastër	57
7.3	Ndërgjegjësimi për kostot e shërbimeve dhe mbështetja nga komuniteti	60
8	Plani i Veprimit, treguesit matës dhe përlogaritjet e kostove.....	61
9	Monitorimi i Planit Vendor MIM	79

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	Të dhënat zyrtare për numrin e popullsisë	16
Tabela 2	Numri i punonjësve dhe shërbimi i fshirjes sipas Njësive Administrative	28
Tabela 3	Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në bashkinë Selenicë	30
Tabela 4	Numri i familjeve dhe vlera e tarifuar për shërbimin e pastrimit në 2024.....	32
Tabela 5	Tarifat vjetore të pastrimit sipas kategorive të biznesit	33
Tabela 6	Buxheti i bashkisë për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në 2022-2023-2024.....	34
Tabela 7	Tarifat e menaxhimit të mbetjeve inerte të ndërtimit	34
Tabela 8	Plani dhe realizimi i të ardhurave nga familjet në 2024	34
Tabela 9	Numri i familjeve të faturuara për shërbimin MM dhe atyre paguese në 2024	36
Tabela 10	Plani dhe realizimi i të ardhurave nga bizneset në 2024	36
Tabela 11	Numri i subjekteve të shërbimit të transportit dhe niveli i arkëtimit në 2024	37
Tabela 12	Plani i Veprimit gjatë periudhës së planifikuar 2025–2030.....	61
Tabela 13	Treguesit matës për arritjen e objektivave të Planit Vendor MIM.....	68
Tabela 14	Kostot e parashikuara për realizimin e masave të Planit.....	73

LISTA E FIGURAVE

Figura 1	Harta administrative e Bashkisë Selenicë	16
Figura 2	Parku arkeologjik i Amantias.....	18
Figura 3	Përbërja merceologjike e mbetjeve në Bashkinë Selenicë.....	25
Figura 4	Përbërja merceologjike e mbetjeve sipas NJA në Bashkinë Selenicë	26
Figura 5	Kamion teknologjik për grumbullimin e mbetjeve.....	29
Figura 6	Kosh me rrota dhe mjete për fshirjen e rrugëve	43
Figura 7	Qendra rajonale e menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë, Vlorë	44
Figura 8	Pamje e përgjithshme e linjës së Impiantit të Rikuperimit të Materialit	46
Figura 9	Skema e procesit të IRM (lënda që hyn në proces: mbetje të përziera).....	47

Të nderuar Këshilltarë e Banorë!

Zbatimi me produktivitet, efikasitet dhe efektivitet i hierarkisë së mbetjeve, mbajtja pastër e mjedisit dhe mbrojtja e shëndetit të njerëzve, promovimi i ekonomisë qarkulluese dhe mbështetja e zhvillimit rural të qëndrueshëm, në bashkëpunim me qytetarët dhe biznesin është vizioni i Bashkisë Selenicë.

Zhvillimi i ekonomisë së gjelbër përbën potencial të rëndësishëm për përmirësimin e nivelit të jetesës së banorëve të Selenicës. Këto veprimtari do të zhvillohen duke ruajtur e konsoliduar burimet natyrore për një mjedis më të pastër dhe shfrytëzim racional të tyre.

Bashkia Selenicë është e qartë dhe kupton se grumbullimi i diferencuar i mbetjeve dhe depozitimi i tyre në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në Sherishtë është një kusht që duhet përmbushur domosdoshmërisht për të mundur një mjedis të pastër.

Nëpërmjet Planit Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, Bashkia synon: reduktimin e mbetjeve në përgjithësi dhe atyre organike në veçanti; ndërgjegjësimin e banorëve për një mjedis sa më të pastër, shtrirjen e skemave të kompostimit në familje edhe në njësitë e tjera administrative si dhe rritjen e arkëtimeve njëkohësisht me cilësinë e shërbimit të pastrimit.

Përmbushja e këtyre objektivave është e kushtueshme, kërkon kohë, përkushtimin tonë por edhe të banorëve të të gjitha njësive Selenicë, Armen, Kotë, Vllahinë, Brataj e Sevaster. Kuptojmë se krahas vendosjes së një sistemi efektiv për grumbullimin e mbetjeve, është e rëndësishme që qytetarët të bëhen pjesë e këtij sistemi. Bashkia do të investojë në edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen qytetare, ashtu sikundër do të bëjmë transparente të gjitha vendimet tona, për të mundur një rol sa më të madh të banorëve në zbatimin e këtij Planit.

Nëpërmjet këtij mesazhi i bëj thirrje administratës vendore si dhe të gjithë banorëve që me përkushtim të bashkëpunojmë për ta bërë këtë Plan një realitet të afërt dhe ta kthejmë Selenicën në një Bashki të gjelbër dhe miqësore me mjedisin.

Kryetari i Bashkisë

Nertil Bellaj

Mirënjohje

Hartimi i këtij Plani është fryt i kontributit shumëpalësh të aktorëve të komunitetit dhe grupit të punës për hartimin e planit vendor të MIMN.

Kontribut të vyer ka ofruar Grupi i Punës(Administrata) për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë, si me sugjerime përgjatë takimeve periodike të grupit të punës ashtu dhe me analizimin e situatës dhe përcaktimin e piketave për të ardhmen që kontribuojnë në arritjen e objektivave të Planit.

Drejtimi metodologjik është mbështetur nga programi Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë, në kuadër të asistencës së Qeverisë Gjermane përmes KfW-së, zbatuar nga INFRASTRUKTUR & UMWELT, RWA dhe FLAG. Skuadra e FLAG, ka ndërmarë udhëheqjen metodologjike dhe lehtësimin e takimeve periodike për rrahjen e ideve dhe identifikimin e sfidave, objektivave dhe masave.

Shkurtime

FLAG	Fondacioni për Autonomi Vendore dhe Qeverisje
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IRM	Impiant për rikuperimin e materialeve
IU	INFRASTRUKTUR & UMWELT
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau)
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
MIMN	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta
MEE	Mbetje elektrike dhe elektronike
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJA	Njësi Administrative
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZMM	Zona e Menaxhimit të Mbetjeve

0 Parathënie

Ky dokument paraqet Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM) të Bashkisë Selenicë, një dokument strategjik për zbatimin e politikave dhe legjislationit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel lokal. Plani është hartuar në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve të Integruar dhe në përputhje me përcaktimet e neneve 12 e 13 të ligjit “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, nr. 10463 datë 22.09.2011, ligji për vetqeverisjen vendore dhe çdo ligj tjetër sektorial të mbetjeve.

PVMIM përshkruan infrastrukturën e kërkuar teknike dhe institucionale, përcakton masat dhe veprimet praktike për menaxhimin, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe cakton përgjegjësitë tek aktorë të ndryshëm bazuar në analizën e gjendjes aktuale për territorin nën juridiksionin e Bashkisë Selenicë, duke përfshirë njësitë administrative Selenicë, Vllahinë, Kotë, Armen, Sevaster e Brataj.

Plani përmban 4 objektiva strategjike dhe 18 objektiva specifike si dhe përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të të gjithë sistemit për menaxhimin e integruar të mbetjeve bashkiake (si ato shtëpiake, mbetjet bio, inerte nga ndërtimet dhe prishjet, mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike, si dhe për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të thata të riciklueshme).

1 Konteksti kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve (MIM)

1.1 Vëzhgim i përgjithshëm mbi menaxhimin e mbetjeve dhe vlerësimi i BE për progresin

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri kryhet në të gjitha zonat urbane dhe më pak në zonat rurale. Sasia e mbetjeve që gjenerohet është rritur dukshëm në dekadat e fundit dhe cilësia e shërbimeve që ofrohen për menaxhimin e tyre ka mangësi. Mbetjet depozitohen kryesisht në vendgrumbullime të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, por kryesisht në zonat që nuk mbulohen me shërbim mbetjet hidhen në vende të paautorizuara, përgjatë rrugëve, anës lumenjve dhe afër vendbanimeve, duke shkaktuar ndikime në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve mund të kryhet përmes kontraktimit të ndërmarrjeve private (me kontrata 3-5 vjeçare) ose nga vetë ndërmarrjet e shërbimeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Pajisjet e grumbullimit (kontenierë dhe kamionë) në disa zona nuk janë sipas standardeve të duhura dhe kanë nevojë për rinovim në mënyrë të vazhdueshme. Nuk janë të zhvilluara skemat e grumbullimit të diferencuar për mbetjet e riciklueshme dhe ndarja në burim aplikohet vetëm në disa zona pilot të qendrave urbane. Nga ana tjetër ndarja e mbetjeve organike dhe kompostimi kryhet vetëm në mënyrë sporadike nga individë në zonat rurale me qëllim plehrimin e tokës.

Shqipëria ka hapur negociatat

1.2 Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Plani i Veprimit

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta bashkiake në Shqipëri drejtohet kryesisht nga synimet dhe afatet kohore të përcaktuara në direktivat e BE-së (si pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) si edhe në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 është hartuar nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 418 datë 17.05.2020. Objektivat specifike të strategjisë janë të ofrojë zgjidhje praktike:

- Për të trajtuar problemet e deritanishme të sistemit të menaxhimit;
- Për të zbatuar kuadrin ligjor në fuqi;
- Për të përmbushur detyrimet specifike të legjislacionit të KE për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë objektivat ambiciozë të paketës për ekonominë qarkulluese.

Pesë qëllimet strategjike përqendrohen në:

1. Përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur parimet kryesore dhe kërkesat ligjore të planifikimit;
2. Përmirësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor për menaxhimin e mbetjeve;
3. Financimin e qendrueshëm të menaxhimit të mbetjeve;
4. Burimet njerëzore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjen e popullatës në menaxhimin e mbetjeve
5. Instrumentat ligjorë, institucionalë dhe financiarë për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Strategjia Kombëtare e MIM i parashikon sistemet e MIMN në bazë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve: “Një Zonë e Menaxhimit të Mbetjeve (ZMM) është një territor që mbulon juridiksionin e një ose më shumë bashkive që kanë një tipologji gjeografike të ngjashme dhe ofron një komunikim të pandërprerë të rrjetit rrugor, gjë e cila lehtëson grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve drejt destinacioneve për para-trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin përfundimtar.”

Në Strategji përcaktohen këto standarde minimale dhe veprimtari me prioritet që lidhen me rrymën e mbetjeve bashkiake:

1. 100% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat urbane (Prioriteti 1)
2. Mbetjet të depozitohen në një vend depozitim të autorizuar dhe të kontrolluar (Prioriteti 1)
3. 90% norma e grumbullimit të mbetjeve në zonat rurale (Prioriteti 2)
4. Ndarja e mbetjeve për të vijuar më tej me riciklimin (Prioriteti 3)

Gjithashtu strategjia përcakton synimet për zbatimin e praktikave të përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve.

Parimet bazë

Parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në direktivën kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, janë:

1. **Hierarkia e mbetjeve** – parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, sipas qëllimit se çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit.
2. **Ndotësi pagan** – lidhet me kostot e ndotjes që duhet të ngarkohen te ndotësit dhe te konsumatorët përgjegjës për të.
3. **Përgjegjësia e zgjeruar e prodhuesit** – është përgjegjësia që duhet të ketë një prodhues apo importues gjatë gjithë ciklit të jetës së produkteve, që prej krijimit deri në shkallën e postkonsumit. Përparësi i duhet dhënë ndarjes së diferencuar të produkteve dhe të materialeve që paraqesin një rrezik më të lartë ndaj mjedisit dhe/ose për ato produkte që ka treg përpunimi për qëllime riciklimi ose rikuperimi.
4. **Parandalimi i rrezikut mjedisor** – nënkupton që kur ka të dhëna mbi praninë e rrezikut mjedisor, duhen marrë masa të përshtatshme parandaluese.
5. **Integrimi** – mbrojtja e mjedisit duhet të jetë pjesë integrale e çdo procesi të zhvillimit të politikave.
6. **Përgjegjësia e ndërsjellë** – të gjithë aktorët e përfshirë në gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve duhet të jenë përgjegjës dhe duhet të bashkëpunojnë për të arritur objektivat e Strategjisë.
7. **Parimi i afërsisë** – mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve.
8. **Përballueshmëria financiare** – niveli i tarifës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë i përballueshëm dhe i pranuar nga komuniteti.

9. **E drejta për informim dhe pjesëmarrje** – çdo qytetar ka të drejtë të marrë informacion rreth menaxhimit të mbetjeve lehtësisht nga të gjitha institucionet përgjegjëse. E drejta për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje nënkupton që publikut duhet të jetë i informuar për të gjitha projektet e lidhura me menaxhimin e mbetjeve dhe duhet t'i jepet mundësia të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
10. **Zbatimi i praktikave më të mira** – për të eliminuar mangësitë, për të siguruar kontrollin dhe zbatimin e standardeve evropiane.

Objektivat specifike të strategjisë janë që të ofrojnë zgjidhje praktike për:

- Përmbylljen e detyrimeve specifike të acquis të KE-së për menaxhimin e mbetjeve dhe të ligjit kuadër për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Zbatimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) që kanë të bëjnë me sektorin e mbetjeve.
- Adresimi i problemeve kryesore të menaxhimit të mbetjeve me të cilat ballafaqohet vendi në një mënyrë të koordinuar dhe të integruar.

1.1.2 Legjislacioni kombëtar për mbetjet

Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta 2019–2032, i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1 datë 13.01.2020, është një instrument planifikues i nivelit të dytë për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri. Meqë disa elementë të sistemit të menaxhimit të mbetjeve kërkojnë zgjidhje në shkallë të gjerë në mënyrë që funksionimi të kryhet me efikasitet kostoje dhe shumica e bashkive në Shqipëri janë të vogla për të siguruar funksionimin efikas të impianteve të mëdha, kërkohet bashkëpunimi ndërmjet bashkive, përkatësisht procesi i ashtuquajtur “rajonalizim” ose ndarja në Zona të Menaxhimit të Mbetjeve. Plani Sektorial përcakton kufijtë paraprakë të Zonave të Menaxhimit të Mbetjeve dhe paraqet kuadrin e planifikimit për investime në infrastrukturën e MMN në secilën ZMM. Plani Sektorial ka këto objektiva specifike:

- të përcaktojë metodologjinë dhe teknologjinë e duhur për investimet e ardhshme në sektorin e MMN,
- të përcaktojë kostot përkatëse dhe nivelet e tarifave në të ardhmen,
- të mundësojë një sistem objektiv, të verifikueshëm dhe transparent për caktimin e prioriteteve për investime në infrastrukturën e MMN,
- të paraqesë një plan investimesh për infrastrukturën vendore dhe rajonale të MMN

1.2 Rolet dhe përgjegjësia në nivelin kombëtar, rajonal dhe vendor

1.2.1 Niveli kombëtar

Përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në Shqipëri ndahen midis nivelit kombëtar, rajonal dhe atij vendor. Këto përgjegjësi funksionale janë përcaktuar në dokumentat kyç që janë hartuar, pra në kuadër të Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe të ndryshimeve të propozuara në Ligjin “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe në Ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është legjislacioni kyç që përcakton përgjegjësitë institucionale në fushën e menaxhimit të mbetjeve në organizmat e qeverisë qendrore, përfshirë AKEM agjensia kombëtare e agjencise së mbetjeve. MTM ka rolin drejtues në kuadrin e përgjithshëm rregullator dhe të politikave për të gjitha llojet e mbetjeve dhe mbikëqyr plotësisht administrimin e mbetjeve të rrezikshme. MTM është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Së bashku me institucione të tjera në varësi të saj, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ministria mban përgjegjësinë për ngritjen dhe monitorimin e një sistemi për menaxhimin e mbetjeve.

Ligji nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ngarkon ministrinë e tjera si ministrinë përgjegjëse për financat, ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë për hartimin e akteve nënligjore specifike sipas përgjegjësive që kanë në fushën e mbetjeve.

1.2.2 Niveli rajonal

Këshillat e qarkut përbëjnë nivelin e dytë të qeverisjes vendore në Shqipëri. Edhe pse jo drejtpërsëdrejti përgjegjës për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal, ato ligjërisht janë ngarkuar për të siguruar kuadrin e politikave rajonale nëpërmjet planeve rajonale për menaxhimin e mbetjeve duke i harmonizuar me politikat kombëtare. Këshillat hartojnë dhe miratojnë planet rajonale për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe i raportojnë MTM çdo vit për zbatimin e tyre (neni 13, Ligji nr. 156/2013 amendim i Ligjit nr. 10463/2011). Gjithashtu këshillat janë përgjegjës për miratimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve para hyrjes në fuqi të tyre. Roli i këshillave të qarqeve është rishikuar vitet e fundit. Strategjia MIM sugjeron një rol të reduktuar për Këshillat e Qarkut në menaxhimin e mbetjeve, duke lejuar studime fizibiliteti në nivel zone mbetjesh që zbatojnë planet vendore të menaxhimit të mbetjeve. Strategjia MIM rekomandon të rishikohen ligjet kyç për të amenduar rolin e Këshillit të Qarkut.

1.2.3 Niveli vendor

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcakton përgjegjësitë dhe autoritetin e bashkisë në drejtim të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Konkretisht, grumbullimi, transporti, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake përkufizohet si një funksion i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të menaxhojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrën që i përshtatet më mirë kushteve të tyre specifike dhe të bashkëpunojnë me bashki të tjera, të caktojnë tarifat e shërbimit dhe një mekanizëm për mbledhjen e të ardhurave, si dhe të ndërtojnë dhe administrojnë impiantet për trajtimin e mbetjeve.

Detyrat specifike të menaxhimit të mbetjeve për bashkitë përcaktohen në Ligjin Nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar dhe disa akte nënligjore. Përgjegjësitë e bashkive lidhen me planifikimin dhe raportimin për menaxhimin e mbetjeve në juridiksionin përkatës. Në nivel vendor, shërbimet për MMN ofrohen ose me personelin dhe pajisjet e vetë bashkive ose nëpërmjet kontraktorëve privatë. Ende i bëhet referencë Ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996, në lidhje me kontraktimin e palëve të treta për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve.

2 Konteksti vendor për menaxhimin e mbetjeve të ngurta

2.1 Profili i Bashkisë

Bashkia Selenicë është një nga 61 Bashkitë e Republikës së Shqipërisë dhe bën pjesë në Qarkun Vlorë. Kufizohet në veri me Bashkinë e Fierit, në lindje me bashkinë e Mallakastrës e

Tepelenës, në jug me bashkinë e Himarës dhe në perëndim me bashkinë Vlorë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Selenicës.



Figura 1 Harta administrative e Bashkisë Selenicë

Bashkia e Selenicës ka një sipërfaqe prej 561.24 km² dhe shtrihet në një zonë kodrinore në bregun e majtë të lumit Vjosa si dhe përgjatë lumit Shushicë.

Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 6 njësi administrative: Selenicë, Armen, Vllahinë, Kotë, Sevastër, Brataj.

Duke hasur vështirësi në përcaktimin e saktë të numrit të popullsisë dhe shmangur mospërputhjet që vijnë nga të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile dhe popullsisë të INSTAT (2023), përdoret formula e ofertës së pakushtëzuar së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censusit dhe Gjendjes Civile për secilën njësi të qeverisjes vendore.

$$\text{Popullsia} = \text{Popullsia (Census)} + [\text{Popullsia (R.Gj.Civile)} - \text{Popullsia (Census)}] * 0.30$$

Popullsia sipas Regjistrit të Gjendjes Civile = 33,771 banorë

Popullsia sipas INSTAT = 9,580 banorë

Popullsia e llogaritur sipas formulës së MF = 16,837 banorë. Bazuar në këtë numër banorësh, Bashkia ka një densitet prej rreth 30 banorë/ km².

Tabela 1 Të dhënat zyrtare për numrin e popullsisë

Njësia Administrative	Popullsia sipas regjistrit të Gjendjes Civile	Popullsia sipas Census (2023)
Selenicë	6,479	1,384
Armen	6,702	1,929
Vllahinë	6,841	1,921
Kotë	6,361	2,136
Brataj	4,539	1,271
Sevaster	2,849	939
Total	33,771	9,580

Emri i Selenicës është i lidhur kryesisht me pasuritë e nëntokës së saj, nxjerrjen dhe shfrytëzimin e bitumit natyror, gjë që ka ndikuar në rritjen dhe zhvillimin e qytetit. Për këto pasuri është dëshmuar në dokumente historike shumë të hershme, por miniera e parë e organizuar daton rreth vitit 1830 dhe për një periudhë të gjatë këto pasuri janë shfrytëzuar nga Perandoria Turke, shoqëritë angleze, franceze e më pas ato italiane para dhe gjatë Luftës II Botërore. Megjithatë aktiviteti i nxjerrjes së minerareve ka ardhur në rënie, edhe sot në minierën historike të bitumit në Selenicë janë të punësuar banorët e Selenicës dhe fshatrave përreth.

Ndërsa zona naftëmbajtëse e Vllahinës është drejt shterimit dhe aktiviteti ekonomik në këtë zonë është i kufizuar ndërkohë që është shkaktuar një ndotje e konsiderueshme mjedisore.

Bujqësia dhe blegtoaria janë aktivitete të rëndësishme ekonomike të popullsisë në bashkinë Selenicë. Si zonë bujqësore, bashkia është e lidhur ngushtë me bashkinë e Vlorës, si treg i rëndësishëm për produktet e saj.

Llojet kryesore të bizneseve që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Selenicë janë:

Qyteti/NJA	Selenicë	Armen	Vllahinë	Kotë	Sevaster	Brataj
Llojet e Bizneseve	Bar-Kafe Ushqimore Shërbime Materiale ndërtimi Farmaci	Bar-Kafe Ushqimore Mobileri Punime mermeri	Bar-Kafe Ushqimore Artikuj të përzier Materiale ndërtimi Farmaci Fabrikë vaji	Bar-Kafe Ushqimore Artikuj të përzier Mobileri Materiale ndërtimi Parukeri Farmaci	Bar-Kafe Artikuj të përzier	Bar-Kafe Ushqimore Artikuj të përzier Mobileri Farmaci

Në Bashkinë Selenicë historia, kultura, traditat dhe zakonet ndërthurren më së miri me njëra-tjetrën duke krijuar një trashëgimi tejet të çmuar. Janë të shumta vendet arkeologjike dhe monumentet kulturore që tërheqin vëmendjen e vizitorëve. Prania e vizitoreve në këtë zonë sjell mundësi të medhaja si dhe sfida në drejtim të menaxhimit të mbetjeve.

Aktualisht, pastrimi i atraksioneve turistike bëhet nepermjet punonjësve të shërbimit të cilët janë të angazhuar sipas planit për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve. Procesi mbështetet gjithashtu nga mjetet e pastrimit të cilat depozitojnë mbetjet drejt pikave të caktuara.

Megjithatë, fluksi turistik në periudha të caktuara sjell rritje të ndjeshme të sasisë së mbetjeve, gjë që kërkon përmirësim të kapaciteteve, organizim dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore për menaxhimin e tyre.

Disa nga atraksionet turistike me fluks me te madh turistesh jane:

Rrënojat e qytetit të lashtë Ilir të Amantias, i cili daton rreth shekullit VI p.e.s, ngrihen në lartësinë shkëmbore prej 613 m mbi nivelin e detit duke shpalosur një peizazh mahnitës midis rrënojave antike.

Figura 2 Parku arkeologjik i Amantias



Atraksion i veçantë në llojin e vet si nga punimi artistik ashtu dhe nga vlerat historike që paraqet është Monumenti i Drashovicës. Në fshatin Velçë vizitorët kanë mundësinë të shohin “Shpellën e Velçës” e cila është një nga vendbanimet shpellore të periudhës prehistorike e zbuluar rreth viteve 1930 nga një mision arkeologjik Italian. Një tjetër atraksion turistik është “Ura e Bratit”, e shekullit XVI me gjatësi 50 m dhe lartësi maksimale 12 m.



Zonat e mbrojtura të trashëgimisë kulturore që përfshihen në territorin e Bashkisë janë:


1. Parku arkeologjik i Amantias në fshatin Ploçë, NJA Sevaster, kufijtë e të cilit janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 396, dt. 31.03.2005.
2. Ura e Slapit në fshatin Kotë e ndërtuar në shekullin e XVII mori statusin Monument Kulture i kategorisë së parë në 1973. Me Vendim nr. 301, dt 09.06.2010 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve zona u shpall zonë e mbrojtur.
3. Zona e mbrojtur e Urës së Frëngut në fshatin Gjorm, NJA Brataj, përcaktuar me vendim të Ministrisë së Kulturës nr. 760 datë 23.11.2017.

2.2 Struktura përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në bashki

Përgjegjësitë për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve ndahen në disa pozicione që mbulohen nga:

1. Drejtoria e shërbimeve Administrative, pastrim dhe Gjelberim

Në organogramën e Bashkisë Selenicë më poshtë detajohet numri i punonjësve që kryejnë shërbimet e menaxhimit të mbetjeve në bashki, sipas organikës të miratuar për vitin 2024




2.3 Sasia e mbetjeve, burimet dhe karakteristikat


Prodhuesit e mbetjeve në territorin e Bashkisë Selenicë janë banorët dhe bizneset e ndryshme që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë territor.

Llogaritja e shkallës së gjenerimit të mbetjeve, duke përdorur koeficientin e parashikuar në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta varion midis 0.6 kg/banor/ditë (fshatra) dhe 0.8kg/banor/ditë (Qyteti Selenicë) me një total vjetor të gjenerimit të mbetjeve prej 3206,7ton/vit.


Kosto për banorë sipas zonave (zona 1 VLLAHINE –KOTE)



Zona 2 (Brataj – Sevaster)



Zona 3 (Selenice –Armen)



Analiza merceologjike e mbetjeve në Bashkinë Selenicë tregon se një pjesë të konsiderueshme (mesatarisht 52%) e zënë mbetjet organike për shkak të natyrës rurale të vendbanimeve dhe aktivitetit bujqësor.




Figura 3 Përbërja merceologjike e mbetjeve në Bashkinë Selenicë

Në secilën nga njësitë administrative vërehen po ashtu ndryshime të lehta në përqindjet e mbetjeve të prodhuara. Siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm, në NJA Armen përqindja e mbetjeve organike është më e lartë krahasuar me NJA e tjera, ndërsa në Selenicë prodhohet sasia më e madhe e mbetjeve të plastikës dhe letrës/ kartonit.




Figura 4 Përbërja merceologjike e mbetjeve sipas NJA në Bashkinë Selenicë

Këto karakteristika i dallojnë mbetjet e gjeneruara në Bashkinë Selenicë nga mesatarja e analizuar nga Konsulenti Institucional për gjithë Rajonin Verior të Vlorës, sipas të cilit 40% e zënë mbetjet organike, ndërsa letra dhe kartoni zënë mesatarisht 19%.

Llojet e mbetjeve	Letër & karton	Plastikë	Metal	Qelq	Organike	Të tjera
100%	19%	11%	1%	5%	40%	24%

2.4 Shërbimet dhe praktikat aktuale të menaxhimit të mbetjeve

Territori i Bashkisë Selenicë ka një shtrirje të gjerë territoriale, duke përfshirë qytetin e Selenicës dhe 47 fshatra. Për shkak të infrastrukturës rrugore dhe terrenit të vështirë bashkia has vështirësi dhe nuk arrin të mbulojë gjithë territorin dhe popullsinë me shërbim. Popullsia që përfiton shërbime të rregullta të grumbullimit të mbetjeve përbën rreth 65% të gjithë popullsisë së bashkisë, pra 10413.2 banorë u ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve bashkiake.

2.4.1 Fshirja e rrugeve

Aktualisht kryhet vetëm procesi i fshirjes së rrugëve dhe shesheve me fshesë nga punonjësit e shërbimeve. Mbetjet që mblidhen nga fshirja e rrugëve hidhen në pikat e grumbullimit të mbetjeve të caktuara nga bashkia, pra në kosha. Ky shërbim ofrohet në gjithë territorin e qytetit të Selenicës dhe në fshatrat Kotë, Vllahinë e Peshkëpi, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2 Numri i punonjësve dhe shërbimi i fshirjes sipas Njësive Administrative

Njësia Administrative	Punonjës pastrimi për fshirjen manuale (nr)	Vendbanimet ku ofrohet shërbimi	Frekuenca
NJA Selenicë	7	Qyteti Selenicë	Çdo ditë
NJA Kotë	2	Fshati Kotë	Çdo ditë
NJA Vllahinë	2	Vllahinë Peshkëpi	Çdo ditë 3 herë/javë
NJA Sevaster NJA Armen NJA Brataj	-	-	-

Në Selenicë sipërfaqja e rrugëve të asfaltuara ku ofrohet shërbimi i fshirjes së rrugëve është $S = 24,000 \text{ m}^2$.

Në Njësine Administrative Vllahinë: fshati Vllahinë $S = 5,400 \text{ m}^2$, fshati Peshkëpi $S = 5,650 \text{ m}^2$, si dhe në Njësine Administrative Kotë, fshati Kotë $S = 5,000 \text{ m}^2$

2.4.2 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve

Në territorin e Bashkisë ka kosha dhe kontenierë për hedhjen e mbetjeve nga qytetarët dhe nje bot uji per larjen e rrugeve 20T.

Mbledhja dhe ngarkimi i mbetjeve në kamionçina kryhet nga punëtorët duke afruar koshin te kamionat e pastrimit. Punëtorët që kryejnë grumbullimin e mbetjeve, pastrojnë edhe ambientin përreth pikave.

Pervec kamionçinave Bashkia Selenicë ka tre kamiona,të cilët përdoren për të ndihmuar në proceset e pastrimit të mbetjeve. Mjete ndihmëse shtesë janë lopata, cfurqe dhe krehëra pastrimi



Figura 5 .Kamion teknologjik për grumbullimin e mbetjeve

Konkretisht, janë në përdorim nga sektori i shërbimeve publike një sasi prej:

- 190 kontenerë me kapacitet 1.1 m³, material çeliku me kapak plastik gri për grumbullimin e mbetjeve
- 50 kosha me kapacitet 50 l për hapësirat publike
- 6 kosha në karrocë me kapacitet 240 litër përfshirë fshesë, lopatë, mbledhës mbetjesh
- 1 kamion teknologjik tip Ford 1833 DC kompaktor me kapacitet 15 m³, me targë AB 181 GE
- 1 kamion teknologjik tip Ford 1833 DC kompaktor me kapacitet 10 m³, me targë AB 361 GE
- 1 kamion mbetjesh vetëshkarkues tip Iveco Daily 70C 16 me kapacitet 6 m³, me targë AB907HA
- 1 kamion transportues me dopio kabinë tip Ford Transit Transporter me targë AB 561 HG.

Bashkia ka bërë një plan paraprak për përdorimin e koshave metalikë në qytetin e Selenicës dhe gjithë Njësitë Administrative të saj, duke e shtrirë shërbimin në më shumë fshatra. Janë caktuar edhe vendndodhjet e sakta të pikave të grumbullimit ku do të vendosen kontenerët e rinj. Vendqëndrimi i mjeteve është në fshatin Peshkëpi, Njësia Administrative Vllahinë.

Do të vazhdohet me itineraret që do të përshkojnë këto mjete dhe ditët kur do të kryhet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve. Makineritë mbarojnë punën për mbledhjen e mbetjeve në terren do të shkojnë direkt në venddepozitimin e Sherishtës ku do të peshohen dhe depozitohen. Për rrjedhojë do të jetë e matshme sasia e mbetjeve të grumbulluara.

Bashkia do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e mjeteve të reja të grumbullimit të mbetjeve, të cilat do të mundësojnë shtrirjen e shërbimit edhe në zona të tjera brenda territorit të bashkisë..

Tabela 3 Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve në bashkinë Selenicë

Njësia Administrative	Vendbanimet ku ofrohet shërbimi	Frekuenca
NJA Selenicë	Selenicë Resulaj	4 herë/ javë
NJA Kotë	Kotë Drashovicë	3 herë/ javë
NJA Vllahinë	Kocul Vllahinë Kropisht Peshkëpi	3 herë/ javë
NJA Sevaster	Shkozë Golimbash Sevaster	2 herë/ javë
NJA Armen	Armen Lubonjë Picar Mesarak	2 herë/ javë
NJA Brataj	Brataj Gjorm Lepenice	2 herë/ javë

2.4.3 Tarifat e pastrimit dhe ekonomia/ financimi i menaxhimit të mbetjeve

Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore përcakton të drejtën e bashkisë për të vendosur tarifa për shërbimin e ofruar dhe cilëson që niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve kërkon që bashkitë të përcaktojnë nevojat buxhetore për ciklin e plotë të menaxhimit të mbetjeve dhe tarifat për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me parimin “ndotësi paguan” dhe atë të “vetëmjaftueshmërisë”.

Në Bashkinë Selenicë tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Selenicë, në çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin. Pagesa për tarifën e pastrimit dhe

largimit të mbetjeve është detyrim vjetor. Detyrimet paguhen brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Kur detyrimi lind 6-mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50% të detyrimit.

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 1 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Selenicë. Qytetarët dhe bizneset marrin faturën e taksës së pastrimit pranë kësaj drejtorie në Bashki dhe kryejnë pagesën pranë çdo pike të Postës Shqiptare. Posta këto pagesa i gjeneron në thesarin e Bashkisë. Të ardhurat e krijuara nga kjo tarifë përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarifë.

Tabela.4 Numri i familjeve dhe vlera e tarifuar për shërbimin e pastrimit në 2024

Njësia administrative	Numri i familjeve	Tarifa (Lekë)	Vlera e tarifuar (Lekë)
Selenicë	1215	1,000	1,275,500
Kotë	921	1000	599,700
Vllahinë	1561	1000	1,392,000
Brataj	1099	1000	575,100
Armen	1,439	1000	901,700
Sevaster	1015	1000	858,500
Total	7250		5,602,500

Tarifat për kategorinë Biznes janë përcaktuar në varësi të llojit dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit. Në tabelën e mëposhtme paraqiten tarifat e pastrimit për bizneset e vogla dhe të mëdha sipas njësive administrative të Bashkisë Selenicë.

Tabela 5 Tarifat vjetore të pastrimit sipas kategorive të biznesit

Nr.	Kategoria biznes	Biznes i vogël			Biznes i madh
		Qyteti Selenicë	Kotë, Vllahinë	Brataj, Armen, Sevaster	Bashkia Selenicë
1	Fabrikë përpunim qumështi	30,000–80,000	30,000–80,000	20,000–80,000	50,000–80,000
2	Fabrikë vaji (4 muaj aktivitet)	15,000–23,000	15,000–23,000	15,000–23,000	25,000–30,000
3	Mbarështim gjedhesh	40,000	40,000	40,000	45,000
4	Thertore	20,000	20,000	20,000	30,000
5	Fabrikë mielli	20,000	20,000	20,000	25,000
6	Fabrikë uji				100,000
7	Punishte duralumin, mobileri	10,000–12,000	8,000–10,000	7,000–9,000	15,000–20,000
8	Subjekte shitje me shumicë	9,000–12,000	7,000–11,000	6,000–9,000	18,000–20,000
9	Subjekte shitje me pakicë	3,000–6,000	3,000–6,000	2,000–5,000	10,000–15,000
10	Njësi shërbimi	6,000–30,000	6,000–30,000	5,000–30,000	13,000–35,000
11	Servis makinash, materiale ndërtimi, etj.	10,000	10,000	8,000	20,000
12	Subjekte shfrytëzimi	20,000	20,000	20,000	25,000–2,000,000
13	Shërbime të ndryshme	7,000–10,000	7,000–9,000	5,000–7,000	13,000–20,000
14	Profesione të lira	10,000–12,000	9,000–10,000	8,000	20,000–25,000
15	Institucione financiare				30,000
16	Banka				30,000
17	Selia e bizneseve	10,000	10,000	10,000	10,000
18	Albtelecom sha				40,000
19	Posta shqiptare				30,000
20	Subjekte me aktivitet treg	12,000	10,000	10,000	25,000
21	Subjekte aktivitet kabllor	20,000	20,000	20,000	25,000
22	Karburante	25,000–30,000	25,000–30,000	20,000–28,000	30,000–35,000
23	Subjekte ambulante	2,000	1,500	1,000	

24	Transport mallrash	3,000–5,000	2,000–4,000	2,000–4,000	4,000–7,000
25	Transport udhëtarësh	3,000–5,000	2,000–4,000	2,000–4,000	4,000–6,000

Për çdo leje ndërtimi deri në 5 kate dhe mbi 5 kate aplikohet tarifë për subjektet ndërtuese. Drejtoria e Planifikimit të Territorit është ngarkuar për mbledhjen e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve. Kjo tarifë duhet të mblidhet para zbardhjes së Lejes së Ndërtimit. Tarifa për pastrimin dhe largimin e mbetjeve të ndërtimit detajohet në tabelën më poshtë:

Tabela 6 Tarifat e menaxhimit të mbetjeve inerte të ndërtimit

Kategoritë	Qyteti Selenicë (Lekë)	Njësitë administrative (Lekë)
Për çdo leje ndërtimi deri në 5 kate	20,000	10,000
Për çdo leje ndërtimi mbi 5 kate	70,000	40,000

Tabela 7. Shpenzimet total te drejtorise se pastrimit ne 3 vite

viti	2022	2023	2024
shpenzimet	36,185,000	37,974,000	39,094,000

Tabela mesiper i referohet shpenzimeve te bashkisë ne zërat e grumbullimit te mbetjeve, transportit, fshirjes dhe punëve te tjera te mirëmbajtjes ne sektorin e mirepmbajtjes se hapësirave publike.

2.4.4 Plani dhe realizimi i të ardhurave

Në përgjithësi niveli i arkëtimit të tarifës së pastrimit nga familjet me një mesatare prej 35% ne 2024 në nivel bashkie. Në tabelën më poshtë, të siguruar nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave në Bashki paraqitet plani dhe realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga familjet sipas Njësive Administrative në vitin 2024:

Tabela 8 Plani dhe realizimi i të ardhurave nga familjet në 2024

Njësitë Administrative	Plani i të ardhurave nga familjet (Lekë)	Arkëtuar nga familjet (Lekë)	Niveli i arkëtimit %
Selenicë	1,275,000	445,796	34%
Vllahinë	1,392,000	306,690	22%
Kotë	599,700	237,900	40%
Sevaster	858,400	29,200	3%
Armen	901,700	331,200	36%
Brataj	575,100	436,378	75%
Totali	5,601,900	1,787,164	31%
Niveli mesatar i arkëtimit nga familjet në bashki			35%

Planifikimi i të ardhurave kryhet në bazë të numrit të familjeve që faturohen në të gjitha njësitë administrative të bashkisë. Siç tregohet në tabelën e mëposhtme në NJA Brataj dhe Vllahinë, niveli i arkëtimit nga familjet është disi më i lartë krahasuar me njësitë e tjera, por në përgjithësi paraqitet në nivele shumë të ulëta.

Tabela9. Numri i familjeve të faturuara për shërbimin MM dhe atyre paguese në 2024

Njësitë administrative	Nr. i familjeve	Faturuar (nr)	Arkëtuar (nr)	Niveli i arkëtimit nga familjet (%)
Selenicë	1215	168	168	13.8
Vllahinë	1561	420	420	27
Kotë	921	281	281	30
Sevaster	1015	12	12	1.2
Armen	1439	381	381	26.4
Brataj	1099	335	335	30
Gjithsej	7250	1597	1597	22%
Niveli mesatar i mbledhjes së tarifës nga familjet				21.4%

Plani dhe realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit nga bizneset e vogla dhe të mëdha sipas njësive administrative për vitin 2024 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10. Plani dhe realizimi i të ardhurave nga bizneset në 2024

Njësitë administrative	Plani i të ardhurave	Arkëtuar	Realizimi %	Nr. i bizneseve
Biznesi i vogël				
Selenicë	425,000	383,000	90%	50
Vllahinë	574,000	374,000	65%	57
Kotë	480,000	220,000	46%	61
Sevaster	81,000	51,000	62%	13
Armen	240,900	76,000	30%	31
Brataj	193,500	96,500	49%	27
Të gjitha NJA	5,839,300	5,238,700	90%	50
Total	7,529,700	6,735,800	92%	

Tabela 11. Numri i subjekteve të shërbimit të transportit dhe niveli i arkëtimit në 2024

Subjektet e shërbimeve të transportit (nr)	Subjekte të faturuara (nr)	Subjekte që kanë paguar (nr)	Niveli i mbledhjes së tarifës (%)
74	74	74	100

3 Planifikimi i menaxhimit të mbetjeve

3.1 Fushëveprimi i Planit Vendor

Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë Selenicë shtrihet në një afat kohor 5-vjeçar 2025–2030 dhe paraqet perspektivat e zbatimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve në gjithë territorin e bashkisë, duke përfshirë qytetin e Selenicës dhe njësitë administrative Vllahinë, Brataj, Kotë, Armen dhe Sevaster.

Ky Plan hartohet për menaxhimin e mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e bashkisë Selenicë, duke marrë parasysh burimet e gjenerimit, sasitë, përbërjen e mbetjeve, infrastrukturën që mundëson proceset e menaxhimit të mbetjeve dhe skemat e organizimit të tyre. Objekt i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve janë të gjitha shërbimet në përgjegjësi të Bashkisë Selenicë në fushën e menaxhimit të mbetjeve, si pastrimi i rrugëve dhe shesheve, grumbullimi, transportimi, trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve bashkiake.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020–2035 me termin “mbetje bashkiake”, për menaxhimin e të cilave janë përgjegjëse Bashkitë, kuptohen:

- mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme
- mbetjet e vëllimshme
- mbetjet e kopshteve, gjethet, degët nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe tregjeve publike (mbetjet bio, sipas përkufizimit të Ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011)
- mbetjet nga aktivitetet tregtare, bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet
- mbetjet nga shërbimet e tjera bashkiake si parqet, lulishtet, etj. (mbetjet bio)

Burimet kryesore të gjenerimit të mbetjeve të ngurta bashkiake janë familjet, bizneset dhe institucionet, por njëkohësisht ato krijohen nga pastrimi i hapësirave publike dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbra. Në zbatim të legjislacionit dhe për të arritur synimet për shmangien e mbetjeve nga vend depozitimi, ndarja e mbetjeve do behet te impanti rajonal bazuar në sistemet e tyre

3.2 Kuadri strategjik

Bashkia Selenicë në bashkëpunim me palët e interesuara synon të arrijë objektivat në mbrojtjen e mjedisit duke aplikuar praktikat me të mira për ruajtjen e burimeve natyrore dhe menaxhimin efektiv të mbetjeve. Duke u fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të riciklimit dhe në bashkëpunimin komunitar, bashkia synon të krijojë një mjedis më të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Vizioni mbi të cilin është hartuar Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve i Bashkisë Selenicë shprehet në formulimin e mëposhtëm:

Vizioni

Bashkia Selenicë zbaton me produktivitet, efikasitet dhe efektivitet hierarkinë e mbetjeve, duke ofruar shërbim për të gjithë qytetarët mban pastër mjedisin dhe mbron shëndetin e njerëzve, duke promovuar ekonomine qarkulluese

Objektivat strategjikë

1. Planifikimi dhe menaxhimi i integruar dhe mjedisor, si dhe trajtimi si burime i mbetjeve bashkiake, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me qytetarët, biznesin dhe shoqërinë civile.
2. Shtirja e menxhimit të mbetjeve në të gjithë terit me efektivitet dhe cilësi për të gjithë qytetarët
3. Ngritja dhe funksionimi efektiv i strukturave, fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
4. Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke mundur vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës së mbetjeve
5. Komunikimi dhe ndërveprimi efektiv dhe transparent i bashkisë me qytetarët dhe bizneset dhe angazhimi i qëndrueshëm i komunitetit në reduktimin dhe menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve

Ky kuadër strategjik përputhet me vizionin e zhvillimit strategjik të Bashkisë Selenicë, i cili është i orientuar drejt ruajtjes dhe administrimit sa më të mirë të potencialeve natyrore që disponon, duke i kthyer asetet natyrore në të ardhura dhe mirëqenie për banorët e saj.

4 Planifikimi i shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve

Bashkia Selenicë do të kujdeset që të ofrojë një shërbim më cilësor për qytetarët duke siguruar dhe vënë në përdorim mjete dhe pajisje të reja. Ajo do të ndjekë vizionin e këtij Plani për shërbime efikase që synojnë pakësimin e mbetjeve dhe rikuperimin e materialeve dhe për një mjedis të pastër që mbështet zhvillimin e qendrueshëm. Do të merren masa për të filluar ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të materialeve të riciklueshme në disa zona urbane në periphery dhe integrim të plot me strukturën e menaxhimit të mbetjeve në rajon.

Njëkohësisht do të nxitet kompostimi i mbetjeve organike në oborr kryesisht në zonat rurale. Këto aktivitete të reja që kërkojnë angazhimin e qytetarëve do të shoqërohen me fushata informuese dhe ndërgjegjëse, veçanërisht me nxënësit e shkollave. Gjithashtu do të vazhdojë t'i kushtohet rëndësi mirëmbajtjes së ambienteve publike dhe mjedisit përreth qendrave të banuara, duke organizuar sipas nevojës aksione pastrimi dhe ndërgjegjësimi për komunitetet përkatëse. Depozitimi i mbetjeve dhe rikuperimi i materialeve do të kryhen në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sheri3htë.

Planifikimi dhe menaxhimi i integruar dhe mjedisor, si dhe trajtimi si burime i mbetjeve bashkiake kryhet në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me qytetarët, biznesin dhe shoqërinë civile.

4.1 Ofrimi i shërbimit MIM në territorin e bashkisë Selenicë



Objektivi specifik 1.1: Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimit të MIM në të gjithë territorin e bashkisë

I gjithë territori i bashkisë duke përfshirë familjet, njësitë ekonomike, institucionet dhe njësitë e tjera do të mbulohet me shërbimin e menaxhimit të integruar mbetjeve. Periudha e parashikuar brenda këtij plani zgjerimi me shërbim do të bëhet .82% duke synuar kapur mbulimin maksimal në zonat urbane dhe shtrirja e shërbimit në zonat rurale me shtrirjen e shërbimit do të nënkuptohet edhe futja e konceptit të parandalimit të mbetjeve kryesisht në zonat rurale të thella duke zbatuar konceptin e kompostimit në shtëpi.

Aktualisht kostot e grumbullimit dhe transportit shkojnë 14,577,967 leke në vit dhe pritet që me funksionimin e Lanfillit kjo kosto të rritet me 10.000.000 leke të reja (kjo kosto është perlllogaritur afërsisht njësoj sa e rajoneve të tjera (2500 leke – 3000 leke / ton). Ndërsa kostot e ndarjes në burim janë kosto të tjera të cilat do të llogariten në vazhdim.

Plani per rritjen e mbulimit me shërbim brenda afatit te këtij plani paraqitet meposhte.

	viti 2025	viti 2026	viti 2027	viti 2028	viti 2029	viti 2030
Mbulimi	65%	65%	67%	68%	68%	82%
Popullsia	10413.2	10413.2	10764.8	11052.35	11116.4	13274.6



	Masat:	Nr
M.1.1.1	Blerja e kontenierëve 1.1 m ³ për grumbullimin e mbetjeve dhe kosha për hapësirat publike; si dhe kosha me mjete për pastrimin e rrugëve	1
M.1.1.2	Përgatitja e planit të shpërndarjes së kontenierëve në territorin e Bashkisë në bazë të numrit të popullsisë	2
M.1.1.3	Përcaktimi i pikave për vendosjen e koshave në fshatrat e çdo NJA, ku është i mundur qarkullimi i mjeteve	3
M.1.1.4	Rehabilitimi i pikave ekzistuese për vendosjen e kontenierëve në hapësirat publike	4
M.1.1.5	Marrja në dorëzim dhe vënia në funksion një kamioni të hapur vetëshkarkues , bazuar në itineraret e përcaktuara të grumbullimit të mbetjeve	5
M.1.1.6	Optimizimi i sistemit për ofrimin e shërbimeve vendore MIM	6
M.1.1.7	Përgatitja e planit të mirëmbajtjes së mjeteve të reja për grumbullimin e mbetjeve	7
M.1.1.8	Hartimi dhe zbatimi i konceptit të monitorimit të mbetjeve për të garantuar shërbime efektive dhe efikase që plotësojnë nevojat e qytetarëve	8

4.1.1 Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve

Infrastruktura për shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Selenicë do të përmirësohet me anë të pajisjeve dhe mjeteve të përfituara përmes programit *Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve të Ngurta në Vlorë*, i financuar nga Bashkëpunimi Gjerman nëpërmjet Bankës KfW për implementimin e një sistemi modern të integruar të menaxhimit të mbetjeve në pjesën Veriore të rajonit të Vlorës.

4.1.2 Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve

Objektivi specifik 1.2: Mbledhja e diferencuar e mbetjeve të riciklueshme dhe të gjelbra

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme të thata

Për të arritur objektivat për riciklimin e materialit nga mbetjet, është e nevojshme që qytetarët, institucionet dhe bizneset të kryejnë ndarjen e mbetjeve në burim. Identifikimi i strategjisë më të



suksesshme të grumbullimit do të bëhet përmes implementimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informimit me nxënësit e shkollave të njësive Administrative dhe qytetit të Selenicës si dhe banorët, të cilët janë potencial i madh për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndryshimin e sjelljes në komunitet.

Qytetarët dhe bizneset do të nxiten t'i ndajnë mbetjet e riciklueshme paraprakisht dhe t'i

hedhin në kosha të veçantë në zonën e tyre të banimit. Për këto materiale (letër/karton, shishe qelqi/ bidona plastikë/ kanaçe alumini, ambalazhe të tjera) të grumbulluara veçmas Bashkia mund të sigurojë transportimin në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë. Në këtë mënyrë materialet e grumbulluara do të trajtohen si rrymë e veçantë në impiantin e rikuperimit të materialit në Sherishtë. Sasitë e materialit të grumbulluar do të përcaktohen nga peshorja në vend depozitimit sanitar. Aty do të peshohen dhe regjistrohen të gjitha dërgesat e materialeve të riciklueshme.

Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve të gjelbra

Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të gjelbra duhet të përfshihen jo vetëm përdoruesit rezidencialë të ndërtesave të banimit, por edhe ambientet e banimit që kanë kopshte perimesh me sasi relativisht të lartë të mbetjeve të gjelbra. Për grumbullimin e veçantë të fraksionit organik të mbetjeve bashkiake do të përdoren mjetet e reja të siguruara nëpërmjet Projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve në rajonin verior të Vlorës. Kontenierët që do të shpërndahen duhet të kenë një madhësi prej 1 m³. Duhet të përdoren kontenierët e çelikut për të shmangur plasaritjet dhe dëmtimet, të cilat mund të çojnë në thyerje të papritura dhe derdhje të përmbajtjes së tyre gjatë përdorimit. Kontenierët duhet të evidentohen qartë (p.sh. duke përdorur kapak me ngjyrë të gjelbër) dhe do të jenë të pajisur me katër rrota me elemente frenuese. Pikat ku do të vendosen kontejnerët duhet të sigurojnë që lëvizja e tyre nga vendi i grumbullimit në pikën e ngarkimit në mjet të jetë i mundur në një terren të sheshtë. Në bazë të sasisë mbetjeve organike/ bio të grumbulluara, do të organizohet zbrazja e kontenierëve.

Sistemi i grumbullimit është projektuar për sasi të mbetjeve organike që do të prodhohen në gjithë territorin e Bashkisë Selenicë.

Shërbimet e grumbullimit të diferencuar do të paraprihen dhe do të shoqërohen me fushata informuese dhe ndërgjegjësuere rreth ndarjes në burim dhe përfitimeve nga rikuperimi i materialeve në mënyrë që të sigurohet bashkëpunimi i qytetarëve.

	Masat:	Nr
M.1.2.1	Vendosja e kontenerëve/ koshave për grumbullimin e diferencuar nga bizneset të mbetjeve të riciklueshme	9
M.1.2.2	Krijimi i një skeme për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme bazuar në marrëveshje bashkëpunimi me sektorin privat, OJF në ZM të Vlorës Veriore	10
M.1.2.3	Vendosja e kontenerëve për grumbullimin e mbetjeve të biodegradueshme	11

4.1.3 Fshirja e rrugëve

Objektivi specifik 1.3: Pastrimi me standard i rrugëve, shesheve, trotuarëve, plazheve dhe i llumrave nga kanalizimet

Fshirja e rrugëve dhe hapësirave publike do të vazhdojë të realizohet në mënyrë manuale nga punëtorët e pastrimit. Për të lehtësuar kushtet e punës dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, do të shtohen dhe vihen në dispozicion të punëtorëve kosha me rrota dhe fshesë. Këto mjete pritet të rritin efikasitetin gjatë punës dhe të reduktojnë në nevojshme për zbrazjen apo mbledhjen e mbetjeve dalin nga procesi i fshirjes.

Ndërsa në rrugët e sheshet e asfaltuara me sipërfaqe 5,650 m² në fshatin Peshkëpi, NJA Vllahinë, shërbimi i fshirjes manuale do të kryhet 3 herë në javë. Gjithashtu bashkia synon të shtrijë ofrimin e shërbimit të fshirjes së rrugëve edhe në fshatrat e njësive Sevaster dhe Brataj,

	Masat:	Nr
M.1.3.1	Vënia në përdorim e koshave me rrota dhe mjeteve për fshirjen e rrugëve	12

4.2 Sistemi rajonal i menaxhimit të mbetjeve bashkiake

Objektivi specifik 1.4: Përfshirja e Bashkisë në sistemin rajonal të menaxhimit të mbetjeve

Bashkia Selenicë si pjesë e Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve të Rajonit Verior të Vlorës dhe përfituese nga projekti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve do të gëzojë të drejtën e përdorimit të infrastrukturës rajonale për menaxhimin e mbetjeve. Ndërtimi i venddepozitimit sanitar të Sherishtës është zgjidhje për problemin e depozitimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Selenicë. Më pak mbetje në vendgrumbullimet e mbetjeve nënkupton një mjedis më të pastër.

4.2.1 Trajtimi i mbetjeve

Depozitimi i mbetjeve urbane do të vazhdojë të kryhet në 2 vendgrumbullimet e mbetjeve që janë në funksion në NJA Selenicë, Sevaster deri sa infrastruktura rajonale të vihet në funksionim dhe Bashkia Selenicë të ketë një marrëveshje zyrtare me Bashkinë e Vlorës për përdorimin e vend depozitimit sanitar.

Sipas autoriteteve përkatëse pritet që Qendra Rajonale e Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë të fillojë të funksionojë në vitin 2026. Të gjitha mbetjet që do të grumbullohen në territorin e bashkisë Selenicë, pas seleksionimit dhe trajtimit në impiantin e rikuperimit të materialit, do të depozitohen në vend depozitimit sanitar të mbetjeve në Sherishtë. Ky vend depozitim sanitar po ndërtohet dhe vihet në punë në përputhje me legjislacionin e BE (Direktivës 1999/31/KE dhe Vendimin e Këshillit 2003/33/KE) dhe legjislacionin shqiptar. Nga ana teknike vend depozitimi do të përmbushë të gjithë parametrat e duhur për të garantuar depozitimin e sigurt të mbetjeve pa shkaktuar dëme në mjedis dhe shëndetin e njerëzve.



Figura 7 Qendra rajonale e menaxhimit të mbetjeve në Sherishtë, Vlorë

Qendra rajonale është e pajisur me një sistem izolimi fundor, i cili bën të mundur mbledhjen e të gjithë lëngut kullues nga mbetjet dhe transportimin e tij drejt pellgjeve të grumbullimit dhe impiantit të trajtimit. Sistemi izolues përbëhet nga: barriera gjeologjike ekzistuese, një gjeomembranë HDPE (2 mm), një shtresë mbrojtëse gjeotekstile dhe një shtresë drenazhimi. Llogaritet që gjithsej të gjenerohet një maksimum prej 22,800 m³ lëng kullues në vit. Trajtimi i lëngut kullues do të bëhet duke përdorur teknologjinë e avancuar të filtrimit “reverse osmosis” e cila siguron rezultate shumë të larta pastrimi. Ndërsa ujërat e rreshjeve do të mbledhen në

sistemin e ujërave sipërfaqësore dhe do të përdoren për pastrimin e rrugëve të brendshme nga pluhuri.

Vend depozitimi parashikohet të prodhojë rreth 107 milion m³ gaz metan, gjatë gjithë jetëgjatësisë së tij. Mbledhja e gazit parashikohet të bëhet nëpërmjet puseve të gazit dhe sistemit të tubacioneve deri në stacionet e mbledhjes së gazit. Gazi i mbledhur do të digjet në flakë të kontrolluar ose do të analizohet mundësia e një motori gazi për prodhim energjie.

Qeliza 1 e vend depozitimit me kapacitet 270,000 m³ parashikohet të ketë një periudhë shfrytëzimi rreth 7 vjet. Ndërsa Qeliza 2 me kapacitet 556,800 m³ do të shërbejë deri në vitin 2045. Pas mbushjes së kapacitetit vend depozitimi do të mbyllet dhe, në përputhje me Direktivën BE 99/31/KE, do të ndërtohet një sistem izolimi sipërfaqësor i përbërë nga: një shtresë e kombinuar degazifikimi dhe stabilizimi (me rërë dhe zhavorr), një shtresë gjeotekstili, një shtresë argjile minerale, një shtresë për drenazhimin e ujit me zhavorr të shtypur dhe një shtresë toke me bimësi.

	Masat:	Nr
M.1.4.1	Hartimi i Marrëveshjes ndërbashkiake me Bashkinë Vlorë për shërbimet rajonale të MIM	13
M.1.4.2	Depozitimi i sigurt mjedisor i mbetjeve urbane në një vend depozitim sanitar dhe përfitimi nga shërbimet në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, Vlorë	14

4.2.2 Rikuperimi i mbetjeve

Objektivi specifik 1.5: Rikuperimi i mbetjeve të riciklueshme dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra

Rikuperimi i mbetjeve të riciklueshme

Analiza e mbetjeve tregon se më shumë se 20% e mbetjeve bashkiake janë fraksione të riciklueshme. Në zbatim të kërkesave të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve për rikuperimin e materialeve për riciklim, ky plan vendor parashikon përdorimin e impiantit për rikuperimin e materialeve (IRM) që do të instalohet në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të

Mbetjeve në Sherishtë, i projektuar me një kapacitet mesatar prej 55,000 t/vit (rreth 30 tonë mbetje në orë).



Figura 8 Pamje e përgjithshme e linjës së Impiantit të Rikuperimit të Materialit

IRM është dizenuar për të nxjerrë veçmas rreth 20% të mbetjeve bashkiake si lëndë të para dytësore. Mbetjet e tjera do të depozitohen në vend depozitimin e ri sanitar. Normat e rikuperimit të lëndëve të thata të riciklueshme të mbledhura veçmas varen nga cilësia e ndarjes (bashkëpunimi i njerëzve). Figura e mëposhtme tregon skemën e procesit të impiantit te rikuperimit.




Figura 9 Skema e procesit të IRM (lënda që hyn në proces: mbetje të përziera)

IRM do të vendoset pranë vend depozitimit sanitar. Në këtë mënyrë thjeshtohet logjistika dhe përdoren efektet e sinergjisë: Të gjitha automjetet që vijnë në qendrën e menaxhimit të mbetjeve kalojnë në peshore përpara se të dorëzojnë mbetjet. Mbetjet do të shkarkohen në një platformë shkarkimi. Një fadromë me rrota do t'i ngarkojë mbetjet tek pajisja për hapjen e qeseve.

Në platformën e shkarkimit dhe përgjatë konvejerit që lidh hapësin e qeseve me ndarësin balistik, do të hiqen fillimisht me dorë ndotësit e mëdhenj dhe materialet voluminoze, si kartonët, materialet plastike, etj. Pas klasifikimit paraprak, metalet me përmbajtje hekuri do të tërhiqen nga një rrip konvejer magnetik. Për heqjen e metaleve pa përmbajtje hekuri, do të përdoret një

makineri e posaçme me fushë të fuqishme magnetike (eddy current separator). Në hapin e rradhës, një ndarës balistik do të ndajë mbetjet në një fraksion të sheshtë (të lehtë) dhe një fraksion rrotullues (të rëndë). Vrimat 20 mm do të ndajnë materialet e imta, të cilat do të transportohen direkt në vend depozitim. Fraksionet e lehta dhe të rënda do të zhvendosen në dy linja të ndarjes së materialeve me dorë. Pjesa e lehtë do të përfshijë kryesisht plastmas dhe qese plastike, letër dhe karton. Fraksioni i rëndë do të përfshijë mbetje organike, dru, materiale masive plastike dhe qelq.

Kompostimi i mbetjeve të gjelbra

Analiza e mbetjeve tregon se më shumë se 50% e mbetjeve bashkiake që gjenerohen në territorin e Selenicës janë organike. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve kërkon reduktimin e sasisë së mbetjeve bio që do të depozitohen në vend depozitime, ndaj në të ardhmen parashikohet edhe grumbullimi i veçuar i mbetjeve organike urbane dhe kompostimi i tyre, për të përmbushur kërkesat ligjore.

Përveç krijimit të një sistemi për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike me pika kolektive grumbullimi, bashkia do t'i mëshojë fort ndërgjegjësimit dhe informimit të banorëve rreth praktikave të kompostimit në shtëpi për të nxitur nisma individuale. Kjo do të reduktojë kostot e transportit dhe të depozitimit në venddepozitim të Sherishtës dhe do të bëjë më të lehtë menaxhimin e mbetjeve organike nga ana e bashkisë.

	Masat:	Nr
M.1.5.2	Prezantimi i skemës për grumbullimin e mbetjeve të gjelbra dhe nxitja e nismave për kompostimin në shtëpi	16

4.2.3 Mbetjet inerte, mbetje nga ndërtimet dhe prishja e objekteve

Objektivi specifik 1.6: Menaxhimi i integruar e mjedisor i mbetjeve inerte nga ndërtimet dhe prishja e objekteve

Depozitimi i mbetjeve inerte do të kryhet në venddepozitimet e përcaktuara me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 41 datë 31.05.2022 në Selenicë dhe njësitë administrative Armen, Kotë, Sevaster dhe Vllahinë, përkatësisht me këto vendndodhje:

1. Vend depozitimi i NJA Armen, me sipërfaqe 700 m² në fshatin Picar
2. Vend depozitimi i NJA Sevaster me sipërfaqe 800 m² në fshatin Golimbas
3. Vend depozitimi i NJA Kotë me sipërfaqe 800 m²
4. Vend depozitimi i NJA Vllahinë me sipërfaqe 700 m² në fshatin Kocul
5. Vend depozitimi i NJA Selenicë me sipërfaqe 1,200 m².



	Masat:	Nr
M.1.6.1	Funksionimi i vend depozitimeve për mbetjet inerte në Selenicë, Sevaster, Kotë, Vllahinë dhe Armen	17

4.3 Përmirësimi i mjedisit dhe peizazhit

Objektivi specifik 1.8: Mbyllja e sigurt dhe me standard e venddepozitimeve historike

Me ndërprerjen e depozitimit të mbetjeve nga ana e bashkisë do të merren masa për përgatitjen e studimit dhe konceptit për rehabilitimin dhe mbylljen e tyre. Po kështu bashkia do të kujdeset edhe për mbylljen e venddepozitimeve të vjetra, duke e rikthyer tokën në hapësirë të gjelbëruar. Venddepozitimi aktual i qytetit të Selenicës është pjesë e projektit të detajuar të rehabilitimit të mbetjeve bashkiake në kuadër të projektit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Në venddepozitimet e tjera të bashkisë mendohet të kryhet procesi i ngjeshjes dhe mbulimi i sipërfaqeve me dhé e më pas mbjellja e pemëve për t'i kthyer në sipërfaqe të gjelbëruara.

Mbyllja e vend depozitimit do të ndjekë procedurat dhe standardin teknik të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për landfillet e mbetjeve”, VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton “kërkesa specifike teknike,

operacionale dhe procedurale për mbylljen dhe rehabilitimin e vend depozitimeve”. Këto masa synojnë parandalimin ose zvogëlimin e efekteve të mundshme negative në mjedis, veçanërisht ndotjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, tokës dhe ajrit dhe çdo lloj rreziku ndaj shëndetit të njerëzve.

Element kryesor i masave të mbylljes dhe rehabilitimit të vend depozitimit është një izolim sipërfaqësor i projektuar, sipas Direktivës së BE-së për Vend depozitimin. Ai do të përbëhet nga elementët e mëposhtëm për të parandaluar gjenerimin e kullimit dhe emetimet e gazit: shtresa e kullimit të gazit; shtresa minerale e papërshkueshme; shtresa kulluese dhe mbulesa e sipërme e tokës. Pas kryerjes së punimeve rehabilituese, do të ndalohet rreptësisht çdo hedhje mbetjesh.

	Masat:	Nr
M.1.8.1	Rehabilitimi dhe mbyllja e 2 vendgrumbullimeve të vjetra në territorin e Bashkisë	15

5 Çështje organizative dhe institucionale

Ngritja dhe funksionimi efektiv i strukturave, fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve.

5.1 Struktura institucionale për shërbimet e MMN

Objektivi specifik 2.1: Ngritja dhe funksionimi i strukturave bashkiake me sisteme pune të modernizuara dhe me kapacitete njerëzore profesionale, që mundësojnë politika dhe plane efektive për MIM

Në Bashkinë e Selenicës do të ngrihet një njësi e posaçme për menaxhimin e mbetjeve, e cila do të jetë përgjegjëse për planifikimin e shërbimeve, koordinimin e punës, monitorimin dhe raportimin. Kjo masë do të jetë në përputhje me masën 22 të Strategjisë Kombëtare për ngritjen e zyrës së menaxhimit të mbetjeve.

Shërbimet vendore të menaxhimit të mbetjeve (fshirja e rrugëve dhe shesheve, grumbullimi i përzierë dhe i diferencuar i mbetjeve, transportimi) do të zbatohen nga Drejtoria e shërbimeve Administrative, pastrim dhe Gjelberim. Kur të krijohet një Ndërmarrje Bashkiake për Shërbimet, përgjegjësitë do të kalojnë tek kjo strukturë e re.

	Masat:	Nr
M.2.1.2	Krijimi i një sektori bashkiak/ njësie për menaxhimin e mbetjeve	16

Objektivi specifik 2.2: Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Ngritja dhe fuqizimi i strukturave administrative në bashki për politikën, aspektet rregullatore, për planifikimin, financimin, monitorimin dhe supervizimin e shërbimit, për hartimin, negocimin, kontraktimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit, zhvillimin dhe përditësimin e statistikave të mbetjeve, nxitjen dhe mbështetjen e komunikimit dhe partneriteteve me komunitetin dhe

biznesin, zhvillimin profesional të burime njerezore të angazhuara me shërbimin MIMM, janë faktorë kyç që garantojnë një shërbim eficient dhe efikas dhe financiarisht të qëndrueshëm. Për këtë është e nevojshme që Bashkia Selenicë të ngrejë Zyrën për MIM, në mënyrë që funksionet administrative që lidhen me shërbimin e MIM të përcaktohen qartë në administratën dhe organikën e bashkisë.

Ngritja e Njesisë për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në administratën e bashkisë është një domosdoshmëri dhe ndërkohë vjen edhe si kërkesë e VKM 418/2020. Kjo njësi duhet të jetë së paku në nivel zyre, me tre punonjës, përfshirë një specialist për politikën e menaxhimit të mbetjeve dhe një specialist mbetjesh i ngarkuar edhe për supervizimin e shërbimit. Kjo njësi do të koordinojë edhe me njësitë e tjera të administratës, kryesisht me njësinë për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimeve.

	Masat:	Nr
M.2.2.1	Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për MIM	17
M.2.2.2	Hartimi i procedurave standarde të veprimit për administrimin e shërbimeve MIM	18
M.2.2.3	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së kostove të shërbimit MIM	19
M.2.2.4	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së tarifave për shërbimin MIM	20
M.2.2.5	Trajnim mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për grumbullimin e mbetjeve	21
M.2.2.6	Trajnim gjatë punës mbi komunikimin efektiv me publikun dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuëse	22

5.2 Kuadri rregullator për menaxhimin e mbetjeve

Objektivi specifik 2.3: Miratimi i kuadrit rregullator për MIM në Bashkinë Selenicë

Rregulloret bashkiake për MIM do të duhet të përcaktojnë qartë standardet e shërbimeve MIM, rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet e prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve si dhe ato të ofruesve të shërbimeve MIM, me qëllim administrimin efektiv në territor të mbetjeve bashkiake.

Rregullorja për menaxhimin e integruar të mbetjeve shtëpiake dhe të ngjashme duhet të përcaktojë qartë standardet e shërbimit, rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të këtyre mbetjeve, oraret e dorëzimit dhe grumbullimit të mbetjeve, modalitetet e ndarjes, dorëzimit dhe grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme, modalitetet e monitorimit të shërbimit,

procedurat për marrjen e shërbimit, procedurat për informimin e qytetarëve dhe bizneseve për shërbimin si dhe ato për trajtimin e ankesave të tyre drejtuar bashkisë në lidhje me cilësinë e shërbimit, etj. Rregulloret bashkiake për MIM duhet të shoqërohen me sanksionet dhe disa nivele gjobash të miratuara nga Këshilli Bashkiak, të cilat duhet të bazohen në parimin "Ndotësi Pague" dhe të mundësojnë që shkelësi të penalizohet në lidhje me kostot shtesë që i shkaktohen bashkisë lidhur me pastrimin apo mbledhjen e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme. Për më tepër, duhet të krijohet një sistem penalizimesh i cili të dekurajojë dhe parandalojë ndotjen e vazhdueshme të territorit dhe të trupave ujorë të bashkisë. Policia Bashkiake, e cila do të jetë përgjegjëse për vendosjen e gjobave dhe sanksioneve ndaj personave fizikë ose juridikë, që kanë shkelur kërkesat ligjore dhe ato të rregullores së MIM në lidhje me dorëzimin, grumbullimin, transportimin dhe depozitimin e mbetjeve, duhet të plotësojnë rregulloren e funksionimit të saj, për të përfshirë në të edhe detyrimet që i vijnë policisë bashkiake nga zbatimi i kërkesave të rregulloreve të mbetjeve.

	Masat:	Nr
M.2.3.1	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve	23
M.2.3.2	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike	24
M.2.3.3	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte	25

5.3 Dokumentimi dhe raportimi

Objektivi specifik 2.4: Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi profesional dhe sipas standardeve i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit

Në zbatim të VKM 687 datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave mbi mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave mbi mbetjet" dhe VKM 538 datë 22.09.2021 do të zbatohet metodologjia për grumbullimin dhe prodhimin e të dhënave për menaxhimin e mbetjeve, sipas shtojcës 4 të VKM 538/2021. Identifikimi i të gjithë gjeneruesve të mbetjeve dhe matja e sasisë së tyre është gjithashtu një nga masat e Strategjisë Kombëtare MIM. Do të krijohet një sistem për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie, i cili do të administrohet nga Njësia e Menaxhimit të Mbetjeve

	Masat:	Nr
M.2.4.1	Krijimi i një sistemi për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie	26

6 Kostoja dhe financimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në të ardhmen

Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke mundësuar vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës së mbetjeve

Objektivi specifik 3.1: Mbulimi i kostos së shërbimeve MIM nga tarifa, duke respektuar parimet e ekonomizimit dhe efijencës

Bashkia Selenicë ka si synim mbulimin e kostos së shërbimit kryesisht nga tarifa dhe të ardhurat e tjera të bashkisë. Duke u nisur nga një sistem i bazuar në tarifë, planifikohet për të rritur nivelin e tarifave në mënyrë progresive për të mbuluar shërbimet e reja të ofruara rishtas për MIM përfshirë shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe amortizimit, duke përdorur subvencione bashkiake apo grante për të mbështetur kostot kapitale. Duke synuar që në të ardhmen kostot e këtij shërbimi të mbulohen në masë më të madhe nëpërmjet tarifave, duhet të merren në konsideratë mundësitë për zgjerimin e bazës së tarifëpaguesve, mënyra më efektive për arkëtimin e tarifave dhe niveli i tyre.

Parimet e politikës tarifore duhet të merren parasysh nga politikëbërësit në përcaktimin e tarifave për shërbimin: (i) mbulimi i kostos, (ii) orientimi drejt parimit “ndotësi paguan”, (iii) përballueshmëria, (iii) barazia horizontale; (iv) barazia vertikale, (v) transparenca dhe (vi) efikasiteti. Ky model tarifar lejon llogaritjen e rritjes së tarifave të kërkuara në lidhje me opsionin e preferuar të tarifimit të shërbimit duke mundësuar grumbullim efektiv të tarifës dhe subvencionim të grupeve në nevojë.

	Masat:	Nr
M.3.1.1	Kryerja e analizës dhe hartimi i politikës për kostimin e plotë të shërbimeve të MIM	27
M.3.1.2	Hartimi i politikës dhe përllogaritja e tarifave për mbulimin e kostos së shërbimit MIM, përmes rritjes progresive të tarifës	28
M.3.1.3	Përpilimi i politikës, objektivave dhe treguesve të performancës për t'i përfshirë në programin buxhetor afatmesëm, për shërbimin e MIM	29

Objektivi specifik 3.2: Ngritja e një sistemi eficient dhe transparent për kostimin e shërbimeve dhe grumbullimin e tarifës së MIM

Specialistët e drejtorisë përgjegjëse për buxhetin do të bashkëpunojnë për analizën e saktë dhe të përditësuar të kostos së ofrimit të shërbimit, bazuar edhe në VKM nr. 319 datë 31.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”. Buxheti vjetor dhe afatmesëm bashkiak do të përfshijë parashikimin e kostos për masat e Planit Vendor të MIM.

Në përgjithësi, nuk ka asnjë model perfekt për përcaktimin e tarifave të shërbimeve. Cilido model që do zgjidhet, duhet të sigurojë mekanizma të shëndoshë për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit vendor të MIM, dhe një qasje e tillë që bazohet në parimet si: (i) efikasiteti i kostos, (ii) mbulimi i kostos, (iii) dhe ndarja e kostos.

Për vlerësimin e ndikimit që do të ketë ky zhvillim i kostove në tarifat për familjet, supozohet që financimi i sistemit të ardhshëm MIM do të mbulohet tërësisht nëpërmjet tarifave. Për të përcaktuar tarifat për secilën kategori subjektësh si dhe strukturën e vendbanimit gjysmë-urbane dhe rurale, kostot llogariten dhe tarifat përcaktohen sipas kushteve lokale dhe normave specifike të gjenerimit të mbetjeve në secilën njësi administrative. Për të siguruar transparencë ndaj publikut, niveli i tarifave së bashku me kostot e shërbimit do të komunikohen nëpërmjet mjeteve të komunikimit të bashkisë, sipas një plani për komunikimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit që do të synojë mirëkuptimin e banorëve dhe subjekteve dhe rritjen e nivelit të pagesave.

	Masat:	Nr
M.3.2.1	Saktësimi i databazës për tarifëpaguesit	30
M.3.2.2	Kryerja e analizës, përpilimi i politikës dhe hartimi i planit të veprimit për mbledhjen e plotë të tarifës për MIM	31
M.3.2.4	Përpilimi i një plani komunikimi dhe ndërgjegjësimi për pagesën e tarifës së MIM, për familjet dhe bizneset	32
M.3.2.6	Përgatitja e formateve të raportimit për monitorimin e brendshëm të performancës financiare	33

7 Informimi publik, pjesëmarrja dhe ndërgjegjësimi

Informimi i qytetarëve rreth shërbimeve të shtuara në Bashkinë e Selenicës do të jetë hapi i parë për t'i ftuar qytetarët të bëhen pjesë aktive e nismave. Mesazhe të një spektri të gjerë që nga çështjet e mbajtjes pastër të hapësirave publike deri në udhëzimet specifike për ndarjen e mbetjeve në burim do të përcillen tek qytetarët dhe bizneset, duke përdorur mjete të ndryshme komunikimi sipas grupeve të synuara.

Procesi i informimit do të realizohet me takime derë-më-derë, në qendra komunitare dhe kryesisht në institucionet arsimore. Në fokus do të jetë edukimi i fëmijëve dhe të rinjve me synim ndryshimin e sjelljes, duke filluar nga ambientet e shkollës e kopshteve dhe duke ndikuar më tej në familje dhe komunitet.

Ndërveprimi efektiv dhe transparent i bashkisë me qytetarët dhe bizneset dhe angazhimi i qëndrueshëm i komunitetit në reduktimin dhe menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve

Objektivi specifik 4.1: Rritja e informimit dhe edukimit të qytetarëve dhe bizneseve dhe veçanërisht e fëmijëve dhe të rinjve për shërbimet e MIM

Bashkia Selenicë synon të sigurojë që qytetarët dhe bizneset të kenë njohuri të mjaftueshme mbi Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe përgjegjësitë e tyre në këtë fushë. Përmes aktiviteteve informuese, materialeve edukative dhe kanaleve të komunikimit, bashkia synon të ndihmojë qytetarët dhe bizneset të kuptojnë rëndësinë e procesit të menaxhimit të mbetjeve dhe impaktin pozitiv që ka në mjedis dhe shoqëri.

Gjithashtu ka një rëndësi të veçantë investimi në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. Përmes programeve edukative nëpër shkolla, fushatave të ndërgjegjësimi dhe aktiviteteve të specializuara, bashkia synon të krijojë ndërgjegjësim dhe të promovojë sjellje të qëndrueshme dhe praktika të mira për menaxhimin e mbetjeve të fëmijët dhe të rinjtë. Për arritjen e këtij objekti bashkia do të kërkojë bashkëpunimin dhe mbështetjen e organizatave që ushtrojnë aktivitete në fushën e mjedisit dhe të stafit pedagogjik nëpër shkolla.

	Masat:	Nr
M.4.1.2	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese/ ndërgjegjësuere (postera, fletëpalosje) dhe publikimi i spoteve ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me Ndërmarrjen e MIM të Bashkisë Vlorë	34
M.4.1.3	Përgatitja dhe zbatimi në shkolla i temave të veçanta për menaxhimin e mbetjeve	35
M.4.1.4	Trajnim i mësuesve të lëndëve përkatëse në shkollat 9-vjeçare rreth temave të menaxhimit të mbetjeve	36

7.1 Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

Objektivi specifik 4.2: Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që marrin pjesë në proceset e hartimit të planeve dhe rregulloreve të MIM

Për të siguruar transparencë në proceset e vendimmarrjes Bashkia Selenicë do të sigurohet që të përfshijë gjerësisht komunitetin gjatë hartimit të rregullores së përgjithshme bashkiake për menaxhimin e mbetjeve, si edhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve inerte dhe rrymave specifike (në përputhje me Nenin 12 të Ligjit 10463/ 2011).

Duke qenë se ofrimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve kërkon nga ana tjetër që qytetarët të ndërveprojnë dhe të integrohen brenda sistemit, është e rëndësishme njohja dhe marrja në konsideratë e nevojave dhe kërkesave specifike të tyre. Takimet komunitare do të zhvillohen me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me rregulloret, si dhe marrjen e komenteve dhe rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.

	Masat:	Nr
M.4.2.3	Takim konsultimi me komunitetin gjatë hartimit të Rregullores së Përgjithshme MIM	36.1

7.2 Shmangia, reduktimi dhe ndarja e mbetjeve për një mjedis më të pastër


Objektivi specifik 4.3: Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e reduktimit të mbetjeve, mbajtjes pastër të mjedisit

Hierarkia e menaxhimit të mbetjeve rendit proceset e ndryshme sipas përparësive që kanë nga pikëpamja e mbrojtjes së mjedisit, përdorimit të burimeve dhe konsumit të energjisë, pra bazuar

në qendrueshmërinë e tyre. Për të qenë i qendrueshëm, menaxhimi i mbetjeve nuk mund të bazohet vetëm në zgjidhje teknike, por nevojitet një qasje e integruar. Qëllimi i hierarkisë së mbetjeve është të nxirren sa më shumë përfitime nga produktet dhe të gjenerohet një sasi sa më e vogël mbetjesh. Zbatimi i duhur i saj sjell një sërë përfitimesh, si parandalimin e emetimeve të gazeve serrë, reduktimin e ndotësve, ruajtjen e energjisë dhe burimeve, nxitjen e teknologjive të gjelbra. Siç paraqitet në mënyrë grafike më poshtë, parandalimi i mbetjeve dhe ripërdorimi janë hapat e parë dhe më të rëndësishëm për të reduktuar sasinë e tyre. Në dekadat e fundit, edhe në Shqipëri kanë ndryshuar sjelljet konsumatore të cilat shkaktojnë prodhimin e sasive më të mëdha të mbetjeve duke e kthyer në sfidë menaxhimin e tyre.

Ndryshimi i sjelljes së qytetarëve dhe rikthimi i praktikave pro-mjedisore është një mision i vështirë dhe kërkon një punë intensive ndërgjegjësuere. Tema e reduktimit të mbetjeve duhet të jetë një nga temat kryesore të aktiviteteve që zhvillohen me nxënësit e shkollave, pasi ata ndihmojnë në përhapjen e mesazheve në familjet dhe komunitetin e tyre.

Në korrik 2022 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë një fushatë kombëtare për ndalimin e qeseve të holla plastike. Kjo fushatë do të shtrihet edhe në nivel vendor në Bashkinë Selenicë, duke u fokusuar në përdorimin e çantave prej tekstili, ashtu si edhe duke nxitur qytetarët të zgjedhin alternativa mjedisore si enët e qelqit dhe artikuj rezistentë me shumë përdorime, të riparojnë sendet e vjetra dhe t'i dhurojnë ose ripërdorin objektet që nuk u nevojiten më.



Ndarja e mbetjeve në burim mundëson nxjerrjen e materialeve të thata të një cilësie të mirë për riciklim. Kjo pjesë e mbetjeve të riciklueshme që diferencohen tashmë trajtohen si lëndë të para

dytësore dhe jo si mbetje. Ato shërbejnë për prodhimin e lëndës së plastikës, kartonit, metaleve, qelqit, të cilat futen përsëri në ciklin e prodhimit.

Nga ana tjetër, diferencimi i mbetjeve organike dhe mbetjeve të gjelbra nga kopshtet dhe aktiviteti bujqësor bëjnë të mundur mbledhjen e materialit të duhur për prodhimin e kompostit, i cili shërben si plehrues organik për pasurimin e tokës.

	Masat:	Nr
M.4.3.3	Pastrimi i mbetjeve në brigjet dhe shtratin e përrenjve/ lumenjve	37
M.4.3.4	Zhvillimi i aksioneve të pastrimit me pjesëmarrjen e qytetarëve	38

Objektivi 4.4: Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që ndajnë mbetjet në burim në zonat që mbulohen me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve

Bashkia synon të inkurajojë ndarjen e mbetjeve në burim si një sjellje e rregullt dhe të promovojë përfitimet që vijnë nga reduktimi i mbetjeve dhe rikuperimi i materialit. Një nga mënyrat për të nxitur banorët është organizimi i fushatave informative dhe ndërgjegjëse.

Krijimi i infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve si dhe caktimi i zonave pilot për grumbullimin e mbetjeve të thata të riciklueshme në zonat urbane duhet të shoqërohet me masa që lehtësojnë ndarjen dhe grumbullimin e mbetjeve në mënyrë efikase. Është thelbësore të realizohet informimi i banorëve rreth shërbimit të ri që ofrohet nga bashkia dhe të rritet ndërgjegjësimi i tyre rreth përfitimeve mjedisore dhe ekonomike. Me anë të masave të renditura më poshtë bashkia synon të rritë numrin e banorëve dhe bizneseve që praktikojnë ndarjen e mbetjeve në burim në zonat e mbuluara me këtë shërbim duke nxitur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive në nismat e bashkisë.

	Masat:	Nr
M.4.4.1	Takim informues/ ndërgjegjëses me bizneset për të ndarë në burim mbetjet e riciklueshme	39

7.3 Ndërgjegjësimi për kostot e shërbimeve dhe mbështetja nga komuniteti

Objektivi specifik 4.5: Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që paguajnë me vullnet tarifën e MIM

Përmes fushatave informuese bashkia synon të tregojë përfitimet dhe kontributin e pagesës së vullnetshme në mbështetje të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit. Bashkia do të inkurajojë banorët dhe bizneset të marrin përgjegjësinë për menaxhimin e mbetjeve dhe të paguajnë tarifën në mënyrë të vullnetshme si një sjellje e qëndrueshme dhe pjesë e angazhimit të tyre për të krijuar një sistem efikas dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve.

	Masat:	Nr
M.4.5.1	Takime informuese/ ndërgjegjësuere me grupe të ndryshme të komunitetit rreth shërbimeve MIM e kostove të tyre	40

8 Plani i Veprimit, treguesit matës dhe përlogaritjet e kostove

Tabela 12. Plani i Veprimit gjatë periudhës së planifikuar 2025–2030

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
1 Planifikimi dhe menaxhimi i integruar dhe mjedisor, si dhe trajtimi si burime i mbetjeve bashkiake, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me qytetarët, biznesin dhe shoqërinë civile	1.1 Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimit të MIM në të gjithë territorin e bashkisë	1	Sigurimi i 50 kontenierëve 1.1 m ³ për grumbullimin e mbetjeve dhe 50 kosha për hapësirat publike							
		2	Përgatitja e planit të shpërndarjes së kontenierëve në territorin e Bashkisë në bazë të numrit të popullsisë							
		3	Përcaktimi i pikave për vendosjen e koshave në fshatrat e çdo NJA, ku është i mundur qarkullimi i mjeteve							
		4	Rehabilitimi i pikave ekzistuese për vendosjen e kontenierëve në hapësirat publike							
		5	Marrja në dorëzim dhe vënia në funksion e nje një kamioni të hapur vetëshkarkues , bazuar në itineraret e përcaktuara të grumbullimit të mbetjeve							
		6	Optimizimi i sistemit për ofrimin e shërbimeve vendore MIM							
		7	Përgatitja e planit të mirëmbajtjes së mjeteve të reja për grumbullimin e mbetjeve							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
		8	Hartimi dhe zbatimi i konceptit të monitorimit të mbetjeve për të garantuar shërbime efektive dhe efikase që plotësojnë nevojat e qytetarëve							
	1.2 Mbledhja e diferencuar e mbetjeve të riciklueshme dhe të gjelbra	9	Vendosja e kontenierëve/ koshave për grumbullimin e diferencuar nga bizneset të mbetjeve të riciklueshme							
		10	Krijimi i një skeme për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme bazuar në marrëveshje bashkëpunimi me sektorin privat, OJF në ZM të Vlorës Veriore							
		11	Vendosja e kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve të biodegradueshme							
	1.3 Pastrimi me standard i rrugëve, shesheve, trotuarëve, plazheve dhe i llumrave nga kanalizimet	12	Vënia në përdorim e 6 koshave me rrota dhe mjeteve për fshirjen e rrugëve							
	1.4 Përfshirja e Bashkisë në sistemin rajonal të menaxhimit të mbetjeve	13	Hartimi dhe lidhja e Marrëveshjes ndërbashkiake me Bashkinë Vlorë për shërbimet rajonale të MIM							
		14	Depozitimi i sigurt mjedisor i mbetjeve urbane në një vend depozitim sanitar dhe përfitimi nga shërbimet në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, Vlorë							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
	1.5 Rikuperimi i mbetjeve të riciklueshme dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra	15	Prezantimi i skemës për grumbullimin e mbetjeve të gjelbra dhe nxitja e nismave për kompostimin në shtëpi							
	1.6 Menaxhimi i integruar e mjedisor i mbetjeve inerte, nga ndërtimet dhe prishja e objekteve	16	Funksionimi i vend depozitimeve për mbetjet inerte në Selenicë, Sevaster, Kotë, Vllahinë dhe Armen							
	1.8 Mbyllja e sigurt dhe me standarte e venddepozitimeve historike	17	Rehabilitimi dhe mbyllja e 4 vendgrumbullimeve të vjetra në territorin e Bashkisë							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
2 Ngritja dhe operimi efektiv i strukturave, fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve	2.1 Ngritja dhe funksionimi i strukturave bashkiake me sisteme pune të modernizuara dhe me kapacitete njerëzore profesionale, që mundësojnë politika dhe plane efektive për MIM	18	Krijimi i një sektori bashkiak/ njësie për menaxhimin e mbetjeve							
	2.2 Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve	19	Organizimi i kualifikimeve për punonjës të sektorit bashkiak për MIM							
		20	Hartimi i procedurave standarde të veprimit për administrimin e shërbimeve MIM							
		21	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së kostove të shërbimit MIM							
		22	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së tarifave për shërbimin MIM							
		23	Trajnim mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për grumbullimin e mbetjeve							
		24	Trajnim gjatë punës mbi komunikimin efektiv me publikun dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese							
	2.3 Miratimi i kuadrit	25	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
	rregullator për MIM në Bashkinë Selenicë	26	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike							
		27	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte							
	2.4 Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi profesional dhe sipas standarteve i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit	28	Krijimi i një sistemi për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie							
3 Zhvillimi i një sistemi të qendrueshëm financiar për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke mundësuar vlerën e koston dhe	3.1 Mbulimi i koston së shërbimeve MIM nga tarifa, duke respektuar parimet e ekonomizimit dhe efijencës	29	Kryerja e analizës dhe hartimi i politikës për kostimin e plotë të shërbimeve të MIM							
		30	Hartimi i politikës dhe përlogaritja e tarifave për mbulimin e koston së shërbimit MIM, përmes rritjes progresive të tarifës							
		31	Përpilimi i politikës, objektivave dhe treguesve të performancës për t'i përfshirë në programin buxhetor afatmesëm, për shërbimin e MIM							
		32	Saktësimi i databazës për tarifëpaguesit							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
përballueshmërinë e pagesës së tarifës së mbetjeve	3.2 Ngritja e një sistemi eficient dhe transparent për kostimin e shërbimeve dhe grumbullimin e tarifës së MIM	33	Kryerja e analizës, përpilimi i politikës dhe hartimi i planit të veprimit për mbledhjen e plotë të tarifës për MIM							
		34	Përpilimi i një plani komunikimi dhe ndërgjegjësimi për pagesën e tarifës së MIM, për familjet dhe bizneset							
		35	Përgatitja e formateve të raportimit për monitorimin e brendshëm të performancës financiare							
4 Komunikim dhe ndërveprim efektiv dhe transparent i bashkisë me qytetarët dhe bizneset dhe angazhim i qendrueshëm i komunitetit në reduktimin dhe menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve	4.1 Rritja e informimit dhe edukimit të qytetarëve dhe bizneseve dhe veçanërisht e fëmijëve dhe të rinjve për shërbimet e MIM									
		36	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese/ ndërgjegjësuere (postera, fletëpalosje) dhe publikimi i spoteve ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me Ndërmarrjen e MIM të Bashkisë Vlorë							
		37	Përgatitja dhe zbatimi në shkolla i temave të veçanta për menaxhimin e mbetjeve							
		38	Trajnim i mësuesve të lëndëve përkatëse në shkollat 9-vjeçare rreth temave të menaxhimit të mbetjeve							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
	4.2 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që marrin pjesë në proceset e hartimit të planeve dhe rregulloreve të MIM	39	Takim konsultimi me komunitetin gjatë hartimit të 1Rregullores së Përgjithshme MIM							
	4.3 Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e reduktimit, mbajtjes pastër të mjedisit	40	Pastrimi i mbetjeve në brigjet dhe shtratin e përrenjve/ lumenjve							
		41	Zhvillimi i aksioneve të pastrimit me pjesëmarrjen e qytetarëve							
	4.4 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që ndajnë mbetjet në burim në zonat që mbulohen me grumbullimin e	42	Takim informues/ ndërgjegjësuës me bizneset për të ndarë në burim mbetjet e riciklueshme							

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Masat		Periudha e planifikimit						
				2025	2026	2027	2028	2029	2030	
	4.5 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që paguajnë me vullnet tarifën e MIM	43	Takime informuese/ ndërgjegjësuere me grupe të ndryshme të komunitetit rreth shërbimeve MIM e kostove të tyre							

Tabela 13 Treguesit matës për arritjen e objektivave të Planit Vendor MIM

Objektiva strategjike	Objektiva Specifike	Tregues	Baza aktuale	Treguesi i arritshem
1 Planifikimi dhe menaxhimi i integruar dhe mjedisor, si dhe trajtimi si burime i mbetjeve bashkiake, në zbatim të hierarkisë së mbetjeve dhe në bashkëpunim me qytetarët, biznesin dhe shoqërinë civile	1.1 Përmirësimi dhe shtrirja e shërbimit të MIM në të gjithë territorin e Bashkisë	1.1.1 Mbulimi me shërbimin e grumbullimit (i popullsisë)	66%	80%
		1.1.2 Norma e grumbullimit (të mbetjeve të prodhuara)	60%	70%
		1.1.3 Mbulimi me shërbimin MIMN (total) në zonat urbane (Selenicë, Vllahinë)	0	35%
	1.2 Mbledhja e diferencuar e mbetjeve të riciklueshme dhe të gjelbra	1.2.1 Sasia e mbetjeve të biodegradueshme të grumbulluara veçmas krahasuar me nivelin në 2016 (në %)	0	10%
		1.2.2 Sasia e mbetjeve të riciklueshme të grumbulluara	0	5%
	1.3 Pastrimi me standard i rrugëve, shesheve, trotuarëve, plazheve dhe i llumrave nga kanalizimet	1.3.1 Sipërfaqe publike në Sevaster dhe Brataj që pastrohen (fshirje) (m ²)	-	1,000

Objektiva strategjike	Objektiva Specifikë	Tregues	Pikënisja	Shënjestra
	1.4 Përfshirja e Bashkisë në sistemin rajonal të menaxhimit të mbetjeve	1.4.1 Marrëveshje ndërbashkiake me Bashkinë Vlorë	-	Po
	1.5 Rikuperimi i mbetjeve të riciklueshme dhe kompostimi i mbetjeve të gjelbra	1.5.1 Sasia e mbetjeve (karton, letër, qelq, metal, plastikë) që shkon për riciklim kundrejt sasisë totale të mbetjeve të gjeneruara për këto rryma (në %)	0	10%
		1.5.2 Familje që praktikojnë kompostimin në shtëpi (nr)	0	50
	1.6 Menaxhimi i integruar e mjedisor i mbetjeve inerte, nga ndërtimet dhe prishja e objekteve	1.6.1 Sasia e mbetjeve inerte, dërguar në venddepozitim të caktuar nga bashkia		100%
	1.8 Mbyllja e sigurt dhe me standarte e venddepozitimeve historike	1.8.1 Sasia e mbetjeve që depozitohen në vend depozitim sanitar kundrejt sasisë totale të mbetjeve të grumbulluara (%)	0	100%
		1.8.2 Mbyllja e sigurt dhe me standarte e venddepozitimeve (numër)		6
2 Ngritja dhe operimi efektiv i strukturave, fuqizimi i	2.1 Ngritja dhe performimi i strukturave bashkiake me sisteme pune të	2.1.1 Ngritja dhe funksionimi i zyrës bashkiake për politikën dhe shërbimet e MIM	-	Po

Objektiva strategjike	Objektiva Specifikë	Tregues	Pikënisja	Shënjestra
kapaciteteve njerëzore dhe zhvillimi i kuadrit rregullator modern për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve	modernizuara dhe me kapacitete njerëzore profesionale, që mundësojnë politika dhe plane efektive për MIMN	2.1.2 Ngritja e ndërmarrjes bashkiake që kryen ofrimin e shërbimeve MIM sipas standardeve ligjore dhe planit të biznesit	-	Po
	2.2 Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të bashkisë në lidhje me menaxhimin e integruar të mbetjeve	2.2.1 Punonjësit e angazhuar me MIM të aftësuar përmes trajnimeve për ushtrimin me efektivitet të detyrave sipas fushës së tyre të përgjegjësisë për MIM		100%
		2.2.2 Numri i personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	0	2
	2.3 Miratimi i kuadrit rregullor për MIMM në Bashkinë Selenicë	2.3.1 Bashkia miraton rregulloret për mbetjet bashkiake	Jo	Po
		2.3.2 Rregulloret bashkiake për mbetjet zbatohen dhe monitorohen periodikisht		Po
	2.4 Dokumentimi, menaxhimi dhe raportimi profesional dhe sipas standarteve i të dhënave për mbetjet bashkiake për të mundësuar politikëbërje mbi bazë evidencash dhe monitorim efikas të shërbimit	2.4.1 Bashkia raporton në mënyrë periodike mbi rrymat e mbetjeve bashkiake	Po	Po
		2.4.2 Bashkia raporton në mënyrë periodike mbi rrymat e mbetjeve bashkiake të rrezikshme		Po
	3.1 Mbulimi i kostos së shërbimeve MIM nga tarifa, duke respektuar parimet e ekonomizimit dhe efijencës	3.1.1 Buxheti i alokuar për shërbimet e MIM kundrejt nevojave për financim nga jashtë bashkisë	69.40%	75%
3 Zhvillimi i një sistemi të qendrueshëm financiar për shërbimet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke		3.1.2 Buxheti i alokuar për shërbimet MIM kundrejt sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara nga bashkia (Lekë shpenzime për 1 tonë mbetje të menaxhuara)	4,421	

Objektiva strategjike	Objektiva Specifikë	Tregues	Pikënisja	Shënjestra
mundësuar vlerën e kostos dhe përballueshmërinë e pagesës së tarifës së mbetjeve		3.1.3 % e mbulimit nga bashkia të kostos për transportin dhe trajtimin e mbetjeve në objektet e trajtimit dhe depozitimit final	100%	80%
		3.1.4 Përqindja e mbulimit nga tarifat e kostos operative dhe asaj të mirëmbajtjes për shërbimet e MIM	26%	
	3.2 Ngritja e një sistemi eficient dhe transparent për kostimin e shërbimeve dhe grumbullimin e tarifës së MIM	3.2.1 Tarifimi i kostos së plotë të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve	44%	100% urbane 80% rurale
		3.2.2 % e tarifës së mbledhur në zonën e shërbimit kundrejt shumës së faturuar (planifikuar) në zonë	famil. 13%, bizn. 85% (2021)	25% 100%
		3.2.3 % e shumës së të ardhurave të realizuara nga tarifa kundrejt kostos totale të shërbimit	26% (2021)	50%
		3.2.4 Përqindja e familjeve paguese të tarifës së MIM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara	13.7%	25%
		3.2.5 Përqindja e bizneseve paguese të tarifës së MIM në zonën e shërbimit kundrejt atyre të tarifuara (2021, gjithsej 401)	73% (293/401 biznese gjithsej)	100%
4 Komunikim dhe ndërveprim efektiv dhe transparent i bashkisë me qytetarët dhe bizneset dhe	4.1 Rritja e informimit dhe edukimit të qytetarëve dhe bizneseve dhe veçanërisht e fëmijëve dhe të rinjve për shërbimet e MIMM	4.1.1 Fushatë për informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e qytetarëve dhe bizneseve të ndërmarra nga bashkia për MIM	Po	Po
		4.1.2 Shkollat përfshijnë tema edukimi rreth menaxhimit të mbetjeve		Po

Objektiva strategjike	Objektiva Specifikë	Tregues	Pikënisja	Shënjestra
angazhim i qendrueshëm i komunitetit në reduktimin dhe menaxhimin e integruar dhe mjedisor të mbetjeve	4.2 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që marrin pjesë në proceset e hartimit të planeve dhe rregulloreve të MIMM	4.2.1 Planet dhe rregulloret e MIM të hartuara me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bizneseve	-	Po
	4.3 Rritja e angazhimit të qytetarëve në aktivitetet e reduktimit, mbajtjes pastër të mjedisit	4.3.1 Fushata pastrimi të ndërmarra çdo vit nga bashkia	50	50
		4.3.2 Qytetarët raportojnë në bashki rreth hedhjes së paligjshme të mbetjeve, zonave të ndotura dhe kontenerëve të pazbrazur	15 ankesa me gojë/vit	15 ankesa me shkrim/vit
	4.4 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që ndajnë mbetjet në burim në zonat që mbulohen me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve	4.4.1 % e numrit të bizneseve që ndajnë mbetjet në burim kundrejt bizneseve që mbulohen me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve		10%
		4.4.2 % e numrit të banorëve që ndajnë mbetjet në burim kundrejt popullsisë që mbulohet me grumbullimin e diferencuar të mbetjeve		10%
		4.4.3 Shkollat që zbatojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve	0	20%
	4.5 Rritja e numrit të banorëve dhe bizneseve që paguajnë me vullnet tarifën e MIM	4.5.1 % e familjeve që paguajnë me vullnet tarifën e MIM kundrejt totalit të familjeve që u ofrohen shërbimet e MIM	8%	20%
		4.5.2 % e bizneseve që paguajnë me vullnet tarifën e MIM kundrejt totalit të bizneseve që u ofrohen shërbimet e MIM	73%	100%

Tabela 14 Kostot e parashikuara për realizimin e masave të Planit

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
1	Sigurimi i 50 kontenierëve 1.1 m³ për grumbullimin e mbetjeve dhe 50 kosha për hapësirat publike	2,000,000	0	0	2,000,000	2,000,000
2	Përgatitja e planit të shpërndarjes së kontenierëve në territorin e Bashkisë në bazë të numrit të popullsisë	0	0	0	0	0
3	Përcaktimi i pikave për vendosjen e koshave në fshatrat e çdo NJA, ku është i mundur qarkullimi i mjeteve	0	0	0	0	0
4	Rehabilitimi i pikave ekzistuese për vendosjen e kontenierëve në hapësirat publike	400,000			400,000	-
5	Marrja në dorëzim dhe vënia në funksion e një kamioni të hapur vetëshkarkues , bazuar në itineraret e përcaktuara të grumbullimit të mbetjeve	2,000,000	0	0	2,000,000	2,000,000
6	Optimizimi i sistemit për ofrimin e shërbimeve vendore MIM	-	-	-	-	-
7	Përgatitja e planit të mirëmbajtjes së mjeteve të reja për grumbullimin e mbetjeve	1,000,000	-	-	1,000,000	-
8	Hartimi dhe zbatimi i konceptit të monitorimit të mbetjeve për të garantuar shërbime efektive dhe efikase që plotësojnë nevojat e qytetarëve	-	-	-	-	-
9	Vendosja e kontenierëve/ koshave për grumbullimin e diferencuar nga bizneset të mbetjeve të riciklueshme	2,000,000	-	-	2,000,000	2,000,000

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
10	Krijimi i një skeme për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme bazuar në marrëveshje bashkëpunimi me sektorin privat, OJF në ZM të Vlorës Veriore	-	-	-	-	-
11	Vendosja e kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve të biodegradueshme	-	-	-	-	-
12	Vënia në përdorim e 6 koshave me rrota dhe mjeteve për fshirjen e rrugëve	60,000	-	-	60,000	60,000
13	Hartimi dhe lidhja e Marrëveshjes ndërbashkiake me Bashkinë Vlorë për shërbimet rajonale të MIM	0	0	0	0	0
14	Depozitimi i sigurt mjedisor i mbetjeve urbane në një vend depozitim sanitar dhe përfitimi nga shërbimet në Qendrën Rajonale të Menaxhimit të Mbetjeve në Sherishtë, Vlorë	24,577,967	-	-	24,577,967	-
15	Prezantimi i skemës për grumbullimin e mbetjeve të gjelbra dhe nxitja e nismave për kompostimin në shtëpi	-	-	-	-	-
16	Funksionimi i vend depozitimeve për mbetjet inerte në Selenicë, Sevaster, Kotë, Vllahinë dhe Armen	-	-	-	-	-

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
17	Rehabilitimi dhe mbyllja e 4 vendgrumbullimeve të vjetra në territorin e Bashkisë	800,000	-	-	800,000	800,000
18	Krijimi i një sektori bashkiak/ njësie për menaxhimin e mbetjeve	9,380,000	-	-	9,380,000	-
19	Organizimi i kualifikimeve për punonjësit e sektorit bashkiak për MIM		500,000	-	500,000	-
20	Hartimi i procedurave standarte të veprimit për administrimin e shërbimeve MIM	-	-	-	-	-
21	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së kostove të shërbimit MIM	0	200,000	0	200,000	-
22	Trajnim i stafit për përdorimin e instrumentit të llogaritjes së tarifave për shërbimin MIM	0	200,000	0	200,000	-
23	Trajnim mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për grumbullimin e mbetjeve	0	200,000	0	200,000	-
24	Trajnim gjatë punës mbi komunikimin efektiv me publikun dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese	0	0	0	0	0
25	Hartimi dhe miratimi i Rregullores së përgjithshme për menaxhimin e mbetjeve	0	0	0	0	0

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
26	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e rrymave specifike	-	-	-	-	-
27	Hartimi dhe miratimi i Rregullores për menaxhimin e mbetjeve inerte	-	-	-	-	-
28	Krijimi i një sistemi për dokumentimin, analizimin dhe raportimin e statistikave të mbetjeve në nivel bashkie	-	-	-	-	-
29	Kryerja e analizës dhe hartimi i politikës për kostimin e plotë të shërbimeve të MIM	-	-	-	-	-
30	Hartimi i politikës dhe përllogaritja e tarifave për mbulimin e kostos së shërbimit MIM, përmes rritjes progresive të tarifës	-	-	-	-	-
31	Përpilimi i politikës, objektivave dhe treguesve të performancës për t'i përfshirë në programin buxhetor afatmesëm, për shërbimin e MIM	-	-	-	-	-
32	Saktësimi i databazës për tarifëpaguesit	-	-	-	-	-
33	Kryerja e analizës, përpilimi i politikës dhe hartimi i planit të veprimit për mbledhjen e plotë të tarifës për MIM	-	-	-	-	-
34	Përpilimi i një plani komunikimi dhe ndërgjegjësimi për pagesën e tarifës së MIM, për familjet dhe bizneset	-	-	-	-	-
35	Përgatitja e formateve të raportimit për monitorimin e brendshëm të performancës financiare	-	-	-	-	-

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
36	Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve informuese/ ndërgjegjësuere (postera, fletëpalosje) dhe publikimi i spoteve ndërgjegjësuere, në bashkëpunim me Ndërmarrjen e MIM të Bashkisë Vlorë	-	100,000	-	100,000	
37	Përgatitja dhe zbatimi në shkolla i temave të veçanta për menaxhimin e mbetjeve	-	-	-	-	-
38	Trajnim i mësuesve të lëndëve përkatëse në shkollat 9-vjeçare rreth temave të menaxhimit të mbetjeve	-	--	-	-	-
39	Takim konsultimi me komunitetin gjatë hartimit të Rregullores së Përgjithshme MIM	-	-	-	-	-
40	Pastrimi i mbetjeve në brigjet dhe shtratin e përrenjve/ lumenjve	400,000	-	-	400,000	-

Masat		Buxheti (Lekë)				Shpenzime kapitale
		Buxheti i shtetit	Bashkia	Donatorë	Total	
41	Zhvillimi i aksioneve të pastrimit me pjesëmarrjen e qytetarëve	-	-	-	-	-
42	Takim informues/ ndërgjegjësues me bizneset për të ndarë në burim mbetjet e riciklueshme		50.000	-	50,000	-
43	Takim informues/ ndërgjegjësues me bizneset për të ndarë në burim mbetjet e riciklueshme	-	50.000	-	50.000	-
	Total	42,617,967	1,300,000		43,917,967	6,860,000

9 Monitorimi i Planit Vendor MIM

Monitorimi i Planit Vendor MIM është një kërkesë ligjore e përcaktuar në Nenin 12 të Ligjit nr. 10 463 dt. 22.9.2011, VKM nr. 687/ 2015 dhe Strategjinë Kombëtare. Ai lidhet ngushtë me dokumentimin e të dhënave dhe ndihmon për raportimet mbi shërbimet e kryera. Zbatimi i këtij PVMIM do të monitorohet duke shqyrtuar rezultatet kundrejt indikatorëve të Planit të përmbledhur në matricën e objektivave. Kjo paraqitje e planit bën të mundur vlerësimin sasior dhe cilësor të realizimit të tij. Pasi të përcaktohet statusi i zbatimit të secilës masë, do të ndërmerret një vlerësim i arritjes në nivel objektivash.

Monitorimi i ecurisë së Planit do të kryhet nga një person përgjegjës në Njësinë e Menaxhimit të Mbetjeve/ Drejtoria e shërbimeve Administrative, pastrim dhe Gjelberim. Personi përgjegjës do të koordinojë punën, do të monitorojë zbatimin e masave dhe do të përpilojë një raport vjetor mbi ecurinë e zbatimit të Planit. Sipas pikës 5, Neni 12 i Ligjit 10,463 për MIM

Monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i planit do të kryhet çdo vit si një praktikë standarde e njësisë përgjegjëse, duke u fokusuar në punën e kryer nga Sektori i Shërbimeve dhe Pastrimit dhe Punëtorët e shërbimeve mbështetëse. Monitorimi do t'i lejojë administratës të shohë nëse masat po zbatohen në përputhje me planin dhe nëse rezultatet e arritura janë si ato të planifikuara. Nëse ka mangësi në zbatim duhet të merren në konsideratë mënyra të tjera për të arritur objektivat e planifikuara dhe Plani mund të rishikohet sipas nevojës.

Konkretisht, vlerësimi i planit do të fillojë me statusin e zbatimit të masave që e përbëjnë atë, duke evidentuar numrin e masave që janë zbatuar, atyre që janë në proces dhe masave që ende nuk janë zbatuar për vitin përkatës gjatë periudhës së planifikimit. Masat e vlerësuara në raport me të gjitha masat e planit do të shprehen me përqindje dhe mund të përdoren si referencë mesatare e zbatimit për nivelet e tjera, përkatësisht objektivat specifike dhe ato strategjike. Kështu për secilin objektiv mund të vlerësohet nëse përmbushja e tij është 1) në nivel mbi mesataren e përgjithshme të planit, 2) të paktën deri në 50% masa të zbatuara ose në proces dhe 3) në nivel të dobët.

Nëse një masë specifike ende nuk ka filluar të zbatohet duhet të analizohen cilat janë arsyet për mosrealizimin apo çfarë pengesa janë hasur. Bazuar në këtë analizë do të merren vendime si mund të përmirësohet niveli i zbatimit të masave të veçanta dhe të Planit në tërësi. Ndërkohë që objektivat dhe masat e përmbushura mund të tërheqin vëmendje për financim të mëtejshëm, sipas nevojës.

Qëllimi i këtij vlerësimi është sigurimi i informacionit të nevojshëm për të mbështetur, së pari, marrjen e vendimeve që do të përmirësojnë zbatimin e planit dhe së dyti, për planifikimin e buxhetit. Gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor të bashkisë, duhet të merren në konsideratë aktivitetet e parashikuara në matricën e Planit për vitin përkatës.

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve mund të rishikohet sa herë që konstatohet se është e nevojshme, por jo më vonë se 5 vjet sipas Ligjit për MIM. Në përfundim të periudhës së planifikimit që mbulon ky dokument, duke marrë parasysh ndryshimin e rrethanave dhe kushteve në bashki si dhe ecurinë e zbatimit gjatë periudhës së mëparshme, duhet të hartohet një Plan i ri Vendor MIM.